



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Opinioni i Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin e vitit 2019.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ervin Bushati dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Gent Sejko – Guvernator i Bankës së Shqipërisë

Erald Themeli – Drejtor në Departamentin e Politikës Monetare

Donald Duraj – Shef i kabinetit në Bankën e Shqipërisë

Erinda Çausi – Përgjegjëse në Sektorin e Komunikimit në Bankën e Shqipërisë

Enri Herri – Përgjegjës i zyrës së protokollit në Bankën e Shqipërisë

Ina Muzaka – Përgjegjëse e zyrës së shtypit

Fabiola Çela – Specialiste për marrëdhëniet me median në Bankën e Shqipërisë

Mira Rakacolli – Zëvendësministre në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale

Albana Fico – Drejtore e Institutit të Shëndetit Publik

Genc Burazeri – Nëndrejtor i Institutit të Shëndetit Publik

Alban Ylli – Shef Departamenti në Institutin e Shëndetit Publik

Antoneta Njehrrëna – Drejtore e Programimit për Standardizimin dhe Harmonizimin

e Kuadrit rregullator, MSHMS

Erjon Luci – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – specialiste në Drejtorinë e Borxhit në Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatmir Elezi – inxhinier në KESH

Anisa Pina – specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Në vijim të shqyrtimit të projektbuxhetit për vitin 2019, sot do të marrim opinionin e Bankës së Shqipërisë lidhur me këtë dokument të rëndësishëm që po diskutohet në Kuvend, përpara miratimit në parim. Për dhënien e opinionit të Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin e vitit 2019 ndodhet në Komisionin e Ekonomisë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zoti Gent Sejko.

Në fillim do të operojmë me paraqitjen e opinionit nga ana e guvernatorit dhe pastaj me pyetje nga deputetët lidhur me atë që do të thotë guvernatori apo për referenca të tjera që kanë të bëjnë me buxhetin e shtetit për vitin 2019.

Zoti Guvernator, fjala për ju.

Gent Sejko – Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni, në radhë të parë, t'ju falënderoj për ftesën dhe mundësinë që më keni dhënë për të paraqitur para jush opinionin e Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin e vitit të ardhshëm.

E gjej me vend të theksoj se hartimi dhe miratimi i këtij dokumenti është një nga momentet më të rëndësishme në jetën ekonomike të vendit. Për këtë arsye, kemi mirëpritur gjithnjë debatin e shëndoshë dhe profesional për objektivat, politikat, instrumentet dhe projeksionet, të cilat përcaktojnë në tërësinë e tyre një projektbuxhet. Në respekt të mandatit institucional të Bankës së Shqipërisë, opinionin ynë do të përqendrohet në diskutimin e ndërlidhjes midis ecurisë së ekonomisë dhe politikës fiskale, sikundër shtjellohet në projekt. Më tej, do t'ju parashtroj gjykimin tonë për ndikimin e strategjisë së huamarrjes dhe të administrimit të borxhit publik në tregun financiar shqiptar. Gjithashtu, dëshiroj të bëj një analizë të përgjithshme të treguesve të qëndrueshmërisë së financave publike të vendit dhe në mbyllje do t'ju paraqes disa sugjerime të Bankës së Shqipërisë për të ardhmen.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Si detajim financiar i politikave qeverisëse, buxheti i shtetit nuk duhet të bazohet thjesht e vetëm në realitetin ekonomik dhe financiar të vendit, por duhet parë edhe si një instrument për përmirësimin e tij. Për këtë arsye, më lejoni ta filloj opinionin tim me

vlerësimin e Bankës së Shqipërisë për zhvillimet ekonomike dhe financiare të vendit, si dhe politikat e duhura për mbështetjen e tyre.

Politika fiskale dhe projektbuxheti i vitit 2019. Sikundër e kemi theksuar dhe në komunikimet tona publike, Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare ndodhet në një trajektore pozitive zhvillimi. Ritmi i rritjes ekonomike është përshpejtuar gjatë tre tremujorëve të parë të vitit aktual, pjesërisht edhe si rezultat i situatës së favorshme hidrike. Punësimi është rritur dhe norma e papunësisë ka rënë, ndërsa bilancet financiare të familjeve, bizneseve dhe sektorit bankar, shfaqen në përmirësim. Po kështu, treguesit kryesorë të balancave makroekonomike janë përmirësuar; inflacioni mesatar i është afruar më tej objektivit gjatë vitit 2018, pavarësisht ndikimit negativ që ka pasur forcimi i shpejtë i kursit të këmbimit; deficit i llogarisë korrente ka ardhur në rënie, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve shqiptare; treguesi i kredive me probleme ka zbritur në nivelin 12.9%, në reflektim të përmirësimit të balanceve të sektorit real, por edhe të masave të marra për adresimin e këtij problemi, si dhe raportimet fiskale tregojnë se deficit i buxhetor mbetet në nivele historikisht të ulëta dhe se borxhi publik ka ardhur në rënie.

Të gjithë treguesit e mësipërm sugjerojnë se pozicioni ciklik i ekonomisë shqiptare është në përmirësim. Me fjalë të tjera, ekonomia është duke lëvizur gradualisht drejt ekuilibrit.

Banka e Shqipërisë vlerëson se premiset e rritjes ekonomike mbeten pozitive. Burimet e rritjes ekonomike paraqiten solide dhe të diversifikuara, si në terma të kërkesës agregate, ashtu dhe në terma të sektorëve prodhues. Paralelisht me të, ambienti i jashtëm mbetet përgjithësisht i favorshëm, ndonëse pasiguritë dhe rreziqet në të janë ende të pranishme dhe jo tërësisht të papërfillshme.

Megjithatë, trendi pozitiv i zhvillimeve nuk do të ishte i mundur pa një miks korrekt politikash ekonomike, të formuar nga kombinimi i politikës monetare stimuluese me politikën fiskale konsoliduese. Nga njëra anë, stimuli monetar ka mundësuar uljen e normave të interesit, nxitjen e kreditimit dhe lehtësimin e kostove të shërbimit të borxhit, duke nxitur zgjerimin e kërkesës agregate dhe duke mbështetur rritjen ekonomike dhe rritjen e punësimit. Nga ana tjetër, konsolidimi fiskal ka mundësuar uljen e primeve të rrezikut dhe të kostos së huamarrjes, si për sektorin publik dhe për atë privat, si dhe ka zgjeruar hapësirat për përballimin e goditjeve potenciale në të ardhmen.

Në opinionin tonë, konsolidimi fiskal duhet të vijojë të jetë ankora kryesore e hartimit të politikës fiskale dhe udhërrëfyese kryesor i zbatimit të Buxhetit edhe në të ardhmen.

Banka e Shqipërisë konstaton se projektbuxheti i paraqitur e përmbush këtë mision. Më konkretisht, ky buxhet parashikon: uljen e mëtejshme të deficitit buxhetor në nivelin 1.9% të PBB-së, kundrejt nivelit 2% të pritur për vitin 2018; ruajtjen e suficitit të balancës primare, i parashikuar të qëndrojë në nivelin 0.5% të PBB-së edhe gjatë vitit 2019, si dhe uljen e borxhit publik në nivelin 65.5% të PBB-së, kundrejt nivelit 69.1% të pritur për vitin 2018.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë vlerëson se projektbuxheti i vitit 2019 mbështetet në projeksione ekonomike dhe fiskale të pranueshme. Në veçanti, niveli i parashikuar i të ardhurave gjendet në kahun e sipërm të parashikimeve tona, i ndikuar edhe nga projeksioni i përmirësimit të procesit të mbledhjes së të ardhurave, por diferencat në projeksione duken të vogla dhe ndikimet janë jomateriale në këtë buxhet.

Bazuar në sa më sipër, ne vlerësojmë se projektbuxheti i vitit 2019 ruan tendencën e konsolidimit fiskal, duke mbetur i harmonizuar me kahun dhe intensitetin e stimulit monetar, duke kontribuar në uljen e primeve të rrezikut dhe të kostove të financimit në ekonomi.

Duke dalë përtej aspektit stabilizues të politikës fiskale dhe duke e parë projektbuxhetin dhe paketën shoqëruese fiskale në këndvështrimin e zhvillimit afatgjatë të vendit, Banka e Shqipërisë konstaton sa më poshtë:

Së pari, projektbuxheti i vitit 2019 parashikon investime publike në nivelin 5.1% të PBB-së. E parë në prizmin e zhvillimit afatgjatë të vendit, si dhe të nevojave të mëdha që kemi për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës, Banka e Shqipërisë e konsideron ruajtjen e nivelit të lartë të investimeve publike si një element të rëndësishëm të çdo projektbuxheti.

Së dyti, paketa fiskale që shoqëron projektbuxhetin nuk parashikon ndryshime rrënjësore në sistemin tatimor. Në përgjithësi, qëndrueshmëria e sistemit tatimor është një zhvillim i mirëpritur nga investitorët vendas dhe të huaj. Në veçanti, Banka e Shqipërisë konstaton se reduktimi i propozuar i taksës mbi dividendin, nga niveli 15% në nivelin 8%, krijon premisa për uljen e kostos së financimit me kapital për bizneset shqiptare. Ky reduktim i shërben potencialisht nxitjes së investimeve vendase dhe të huaja, si dhe ndihmon në përmirësimin e strukturës dhe rritjen e qëndrueshmërisë së bilancit të bizneseve, duke rritur peshën e financimit me kapital dhe duke ulur peshën e financimit me fonde të marra hua.

Së treti, projektbuxheti i vitit 2019 synon vijimin e luftës kundër informalitetit. Banka e Shqipërisë ka mbështetur dhe mbështet çdo nismë që promovon konkurrencën e ndershme në ekonomi. Këto nisma nuk sjellin vetëm shëndoshjen e bilancit të sektorit publik,

por prezantojnë stimujt e duhur për rritjen e eficiencës në sektorin privat dhe sigurojnë një shpërndarje më të mirë të burimeve në ekonomi.

Më lejoni tani të kaloj te zhvillimet e tregjeve financiare dhe ndërthurja e tyre me nivelin dhe strategjinë e financimit të borxhit publik.

Tregjet financiare, deficitit buxhetor dhe borxhi publik. Projektbuxheti i vitit 2019 parashikon një deficit buxhetor prej 32.9 miliardë lekësh, ose 1.9% e PBB-së. Ky deficit parashikohet të financohet në masën 25.7 miliardë lekësh ose 1.5% të PBB-së nga fondet e siguruar gjatë vitit 2018 dhe në masën 22.9 miliardë lekë ose 1.3% të PBB-së nga financimi i brendshëm. Në të kundërt, niveli i borxhit të huaj parashikohet të ulet në masën 15.7 miliardë lekë ose 0.9% të PBB-së.

Në vijim të objektivave të dyfishtë që duhet të ketë strategjia e huamarrjes dhe e administrimit të borxhit, uljen e koston e financimit dhe minimizimin e rrezikut të likuiditetit dhe luhatshmërisë së borxhit, Banka e Shqipërisë vlerëson se ky plan financimi është i arsyeshëm.

Në vijim të politikës sonë monetare lehtësuese, por edhe në mbështetje të procesit të konsolidimit fiskal, tregu financiar shqiptar paraqitet i qetë, me norma të ulëta interesi dhe me tregues të mirë likuiditeti. Në veçanti, sektori bankar shfaqet likuid, i mirëkapitalizuar dhe me tregues përfitueshmërie në përmirësim.

Strategjia e huamarrjes duhet të vazhdojë të orientohet drejt rritjes së kohëzgjatjes mesatare të borxhit, çka redukton rrezikun e rifinancimit dhe në uljen e peshës së instrumenteve me kosto të luhatshme, duke ulur luhatjet dhe rritur parashikueshmërinë e flukseve të shërbimit të borxhit publik. Paralelisht me të, në afatin e mesëm dhe të gjatë, administrimi i borxhit publik duhet të fokusohet më shumë në diversifikimin e bazës së investitorëve, duke rritur vëmendjen ndaj zgjerimit të tregut të brendshëm nëpërmjet përmirësimit të funksionimit të tregut sekondar të letrave me vlerë; kufizimin e huamarrjes në valutë të huaj, e cila në një regjim të lirë të kursit të këmbimit, si ai që aplikohet në Shqipëri është premisë për luhatje të larta si në nivelin e borxhit dhe në nivelin e koston e shërbimit të borxhit; fuqizimin e strukturave dhe përmirësimin e strategjive të administrimit të borxhit, duke nënkuptuar një analizë më të integruar të kostove dhe përfitimeve të strategjive të ndryshme të administrimit.

Nevoja për përmirësimin e strukturave dhe strategjive të administrimit të borxhit publik bëhet edhe më emergjente po të marrim parasysh dy trende të rëndësishme.

Së pari, tendenca e rritjes së peshës së borxhit të financuar me kushte tregu ndaj peshës së borxhit të marrë me terma koncesionarë, e ekspozon gjithnjë e më shumë nivelin

dhe strukturën e borxhit, si dhe shëndetin e financave publike shqiptare, ndaj vëmendjes së tregjeve financiare ndërkombëtare.

Së dyti, financimi i borxhit gjatë viteve të fundit ka përfituar nga një ambient tejet i favorshëm, në terma të normave të ulëta të interesit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj financiar. Përmirësimi i vazhdueshëm i ekonomisë evropiane dhe asaj shqiptare nënkupton që këto norma interesi do të vijnë drejt rritjes, në linjë dhe me komunikimet respektive të bankave qendrore.

Të nderuar deputetë, seksioni në vazhdim do të përmbledhë opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike.

Qëndrueshmëria afatgjatë e financave publike. Ligji organik i buxhetit parashikon klauzola specifike, të cilat synojë të disiplinojnë politikën fiskale në drejtim të eficiencës së përdorimit të fondeve dhe në drejtim të ruajtjes e forcimit të shëndetit afatgjatë të financave publike.

Banka e Shqipërisë konstaton se këto klauzola janë përmbushur. Projektionet e prodhimit kombëtar bruto janë në terma nominalë brenda projeksioneve të fundit të disponueshme të FMN-së. Po ashtu, trajektorja e borxhit publik është në rënie, investimet publike janë ndjeshëm më të larta se vlera e deficitit buxhetor dhe projekti parashikon kontigjenca për përballimin e luhatjeve të dëmshme të kursit të këmbimit dhe të normave të interesit.

Projektbuxheti i vitit 2019 shoqërohet edhe me tabelën e projeksioneve afatmesme të financave publike. Kjo tabelë sugjeron vazhdimin e konsolidimit fiskal, si në horizontin afatmesëm, ashtu edhe në atë afatgjatë.

Në këtë prizëm, Banka e Shqipërisë konstaton se deficitin e skemave të sigurimeve shoqërore, sigurimeve shëndetësore dhe sigurimeve të tjera sociale, është rreth 4.6% e PBB-së, ose 2.6 herë më i lartë se deficitin e përgjithshëm buxhetor. E parë më në detaje, deficitin e skemës së sigurimeve shoqërore apo skemës së pensioneve, pritet të jetë rreth 1.5% e PBB-së, brenda parashikimeve të bëra në reformën e këtij sistemi dhe në një trajektore rënëse. Nga ana tjetër, deficitin e skemave të tjera paraqitet më i qëndrueshëm. Përtej kundërciklikalitetit që kanë elemente të ndryshme të këtyre skemave, Banka e Shqipërisë gjykon se duhen parë hapësirat për reduktimin e mëtejshëm të deficitit të tyre strukturor.

Së fundi, projektbuxheti i vitit 2019 paraqet një risi në drejtim të vlerësimit eksplicit të rreziqeve të mundshme ndaj realizimit të buxhetit. Banka e Shqipërisë e mirëpret këtë risi dhe inkurajon që ajo të jetë pjesë integrale e planeve të buxheteve vjetore afatmesme dhe afatgjata.

Në lidhje me këta skenarë rreziku, Banka e Shqipërisë ka komentet e mëposhtme:

Së pari, vlerësimi i ndikimit të goditjeve të mundshme negative, në ekonomi apo në të ardhurat publike, duhet të shoqërohet me identifikimin e masave që duhen marrë në drejtim të reduktimit të shpenzimeve, për respektimin e vlerës së deficitit buxhetor.

Së dyti, vlerësimi i rrezikut që vjen nga programet e partneritetit publik-privat, sugjeron se shmangiet nga kërkesat e ligjit për pagesat vjetore të PPP-ve deri në nivelin 5% të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës do të përballohen nëpërmjet rritjes së të ardhurave. Banka e Shqipërisë gjykon se përtej këtij mekanizmi rregullues në funksion të respektimit të tavanit ligjor, rritja e mundshme e deficitit buxhetor duhet të shmanget nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve buxhetore. Për më tepër, ky reduktim duhet të garantojë në maksimumin e mundshëm sektorët buxhetorë, të cilët i prodhojnë këto shmangie.

Sanksionimi i këtij parimi i shërben ruajtjes së balancave buxhetore, ruajtjes së balancave në shpërndarjen ndërsektoriale të fondeve dhe disiplinimit të kontraktimit të këtyre programeve. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë sugjeron nevojën e zbatimit të standardeve më të mira në fushën e kontabilizimit të ndikimit të tyre në treguesit e borxhit.

Në vijim po vazhdoj me disa sugjerime të tjera të Bankës së Shqipërisë për rritjen e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së financave publike.

Së pari, ritmi i konsolidimit fiskal në afatin e mesëm. Përmirësimi i pozicionit ciklik të vendit, apo me fjalë të tjera shfrytëzimi më i plotë i kapaciteteve prodhuese të ekonomisë, lehtëson barrën e konsolidimit fiskal. Banka e Shqipërisë sugjeron që në përputhje me shkallën dhe ritmin e përmirësimit të ekonomisë, të merret në konsideratë mundësia e shpejtimit të ritmit të konsolidimit fiskal në afatmesëm. Ky përshpejtim do të shërbente për të akomoduar rritjen e pritur të kostos së shërbimit të borxhit në afatmesëm, si dhe do të rriste hapësirat për përballimin e goditjeve të mundshme negative në afatgjatë.

Mbi sistemin tatimor. Banka e Shqipërisë vlerëson se, përpos stabilitetit të regjimit tatimor, një tipar tjetër i dëshirueshëm i politikës së taksave është dhe thjeshtimi i sistemit, në drejtim të reduktimit të përjashtimeve tatimore. Një sistem i thjeshtë tatimor lehtëson barrën e administrimit të sistemit tatimor dhe tenton të përmirësojë eficiencën e shpërndarjes së burimeve në ekonomi.

Mbi pasurimin e mëtejshëm të rregullit fiskal. Përfshirja e klauzolave të përgjegjshmërisë fiskale në ligjin organik të buxhetit ishte një hap i madh përpara në drejtim të sanksionimit ligjor të qëndrueshmërisë fiskale. Megjithatë, duke përfituar nga koha dhe eksperiencia e akumuluar, Banka e Shqipërisë do të sugjeronte pasurimin e ligjit me klauzolat e mëposhtme:

Identifikimin e një shpejtësie të dëshiruar të konsolidimit fiskal gjatë harkut të një viti buxhetor, për të orientuar më mirë procesin në terma afatmesëm e afatgjatë.

Përfshirjen e tavaneve mbi vlerën e përgjithshme të kontraktuar të PPP-ve. Banka e Shqipërisë vlerëson se përfshirja e tavaneve mbi vlerën e përgjithshme të kontraktuar të PPP-ve në ligjin organik të buxhetit do të ishte një element plotësues i kufizimit të parashikuar në këtë ligj mbi kufijtë maksimalë të lejuar, për alokimin e fondeve për shërbimin e PPP-vë në një vit buxhetor. Gjithashtu, do të ankoronte në baza më të qëndrueshme, detyrimet potenciale që i vijnë buxhetit nga PPP-të.

Mbi ritmin e realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit. Ritmi i realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit vazhdon të shfaqë një përqendrim të theksuar në tremujorin e katërt. Ky fenomen i përsëritur dhe i diktuar në masën më të madhe nga ritmi jo i njëtrajtshëm i realizimit të investimeve publike, krijon luhatje të panevojshme gjatë vitit në treguesit e likuiditetit dhe të normave të interesit në tregun e brendshëm financiar. Gjithashtu, ai tenton të vështirësojë kontrollin e shpenzimeve dhe të respektimit të limiteve të buxhetit, si dhe të reduktojë efektivitetin e tyre.

Mbi administrimin e programeve të partneritetit publik – privat. Në plotësim të komenteve të mëparshme mbi këto programe, gjej me vend të theksoj edhe një herë nevojën për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të njësive që administrojnë vlerësimin, kontraktimin dhe monitorimin e këtyre projekteve, sidomos për sa i takon anës ligjore dhe asaj financiare. Gjithashtu, PPP-të e kontraktuara në lëmin e investimeve publike duhet të jenë konform programit strategjik afatmesëm e afatgjatë të investimeve, sikundër janë identifikuar në programet e zhvillimit të vendit.

Ky ishte opinioni i Bankës së Shqipërisë lidhur me projektbuxhetin e vitit 2019.

Faleminderit për vëmendjen!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Guvernator!

Fjalën e ka zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Guvernator, për prezantimin e opinionit dhe sugjerimeve të Bankës së Shqipërisë në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2019.

Unë kam disa pyetje që lidhen me kursin e këmbimit, borxhin publik dhe kreditimin.

Për kursin e këmbimit. Të gjithë jemi në dijeni të situatës së zhvlerësimit të euros gjatë këtij viti, e cila arriti në nivelet më të ulëta në 10 vjetët e fundit, gjë që e detyroi Bankën e Shqipërisë të ndërhynte për të frenuar uljen e mëtejshme të këtij kursi këmbimi. Unë dua të di se si është situata aktuale e kursit të këmbimit, në lidhje me euron. Cilat janë pritshmëritë

apo parashikimet për të ardhmen për aq sa mund të parashikohet, sepse ne e dimë që është shumë e vështirë të parashikohet kursi i këmbimit dhe çfarë efektesh mund të kenë këto ndryshime në ekonomi, pra në treguesit ekonomikë dhe financiarë të vendit?

Për borxhin publik. Në seancën e kaluar këtu në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, diskutuam mbi statistikën dhe parashikimet, të cilat janë pozitive, pra aktualisht për vitin 2019 pritet të jetë 69.1%, ndërkohë që parashikimi për vitin e ardhshëm është 65.5% dhe në fund të mandatit, pra në vitin 2021 pritet që borxhi publik të zbresë në nën 60% të produktit të brendshëm bruto. Unë dua të di, sipas këndvështrimit tuaj se cila është strategjia më e mirë për të financuar borxhin publik.

Për kreditimin. Aktualisht kreditimi vazhdon të ketë probleme, edhe pse ka pasur rritje në muajt e fundit. Për shembull, në muajin korrik sipas shifrave që kam është rritur me 2 miliardë lekë, pra situata është përmirësuar pak, por përsëri vazhdon të jetë problematike. Sipas studimeve që ka bërë Banka e Shqipërisë apo analizave që ju keni, përse nuk po rritet kreditimi në nivelet e nevojshme për të mbështetur rritjen ekonomike?

Së fundi, kam një pyetje lidhur me risqet ekonomike dhe financiare. Ju përmendët diçka në lidhje me këtë, madje dhatë edhe disa sugjerime, por për ju e kam pyetjen më të përgjithshme. Gjithashtu, këtë pyetje ia kam bërë edhe ministrit të Financave, por në fakt u fokusova tek të ardhurat buxhetore. Pra, pyetja ime ka lidhje me risqet që paraqet grumbullimi i të ardhurave buxhetore në ekonominë dhe financat e vendit. Çfarë sugjerimesh keni ju për ne, politikbërësit, për t'u paraprirë këtyre risqeve? Pra, çfarë masash duhet të marrim ne për t'u paraprirë këtyre risqeve?

Faleminderit!

Gent Sejko – Faleminderit, zonja Kushi!

Ju më bëtë katër pyetje, ndaj po filloj me pyetjen e parë lidhur me kursin këmbimit.

Kursi i këmbimit ka filluar mbiçmimin e tij kundrejt valutave që nga viti 2015. Pra, ka qenë një mbiçmim dhe një forcim i lekut kundrejt euros kryesisht, por edhe dollarit dhe valutave të tjera. Pra, ka pasur një vlerësim konstant, por ky vlerësim gjatë vitit aktual është përforcuar dhe është theksuar më shumë sidomos gjatë periudhës 3-mujorit të dytë të vitit.

Ne e kemi theksuar vjet, por edhe sivjet, se mbiçmimi i kursit ka qenë i shpejtë në periudhën para sezonit të verës. Në analizat tona rezulton se mbiçmimi i kursit të këmbimit ka ardhur kryesisht nga faktorë fundamentalë, nga faktorë strukturorë të ekonomisë shqiptare. Shifrat kanë justifikuar dhe vërtetuar një mbiçmim të kursit të këmbimit, që reflekton hyrje të mjaftueshme të euros kryesisht në ekonomi, si dhe të valutave të tjera, nga burime formale, fundamentale, siç kanë qenë investimet e huaja direkte në ekonomi, rritja e nivelit të

renitancave, të ardhurat nga turizmi, të ardhurat nga vizitorët dhe nga elementë të tjerë që janë burime të të ardhurave. Natyrisht, ne ndjekim një regjim të lirë të kursit të këmbimit dhe do të vazhdojmë ta ndjekim këtë regjim. Kjo i shërben fleksibilitetit dhe rezistencës të ekonomisë shqiptare nga goditjet e huaja dhe të brendshme. Në momente të caktuara Banka e Shqipërisë gjykon dhe vlerëson, bazuar edhe në rregulloren, në politikat dhe strategjitë e saj, kur ka çrregullime dhe faktorë spekulativë në nivelin e kursit të këmbimit. Më kryesorja është se ka një mbiçmim të përshpejtuar të kursit të këmbimit, i cili ndikon në nivelin e inflacionit, pasi objektivi ynë primar, si bankë qendrore, me ligj është stabiliteti i çmimeve, pra niveli i synuar dhe i targetuar i inflacionit, të cilin ne e kemi 3%. Atëherë, ne në bazë të analizave, marrim edhe vendim për të ndërhyrë. Pra, mund të kemi ndërhyrje për çrregullim, bazuar në rregulloren tonë, kur ka spekulime ose deformime të regjimit valutor të kursit të këmbimit, ose mund të ndërhyjmë në rast se kemi një çmim të theksuar, i cili ka të bëjë me nivelin e inflacionit. Në rastin konkret ne i kishim të dyja elementet, sidomos në fillim të vitit, pasi pritëshin disa transaksione të mëdha. Pra, ne kishin një pritshmëri të madhe gjatë verës, gjë e cila lidhej si me kredinë e BERZH-it, që ishte rreth 250 milionë euro dhe në një moment të caktuar u disbursuan rreth 18 milionë euro, por ishte konvertimi i kapitalit të disa bankave, që ishte po ashtu mbi 100 milionë euro, nuk e mbaj mend shifrën e saktë. Pra, ishin disa transaksione, që përkuan rastësisht me periudhën e sezonit turistik, të cilat do të sillnin prurje të mëdha.

Këto pritshmëri e udhëhoqën kursin e këmbimit dhe mbiçmimin më të madh se sa faktorët fundamentalë. Një situatë e tillë u vu re kur kursi ra më shumë dhe u forcua leku, ndaj Banka e Shqipërisë mori një vendim për të stabilizuar kursin e këmbimit. Aktualisht ne shikojmë që kursi i këmbimit vazhdon të jetë i mbiçmuar.

Analiza e Bankës së Shqipërisë lidhur me kursin e këmbimit është e vazhdueshme. Ne, së bashku me departamentin e kërkimeve, me departamentet e tjera të politikës monetare dhe stabilitetit financiar, si dhe me grupet e punës vazhdojmë të marrim analiza. Faktori kohor është shumë i rëndësishëm për të gjykuar dhe për të kuptuar se cilët faktorë ndikojnë në kursin e këmbimit, por është e pamundur të parashikosh kursin e këmbimit, sepse është i paparashikueshëm. Në rast se ne do të parashikonim kursin e këmbimit, atëherë do ta dinim saktësisht sa do të ishte.

Mbiçmimi i kursit të këmbimit në analizat tona na rezulton se është një *all drive*, i udhëhequr dhe i ndikuar më shumë nga faktorët strukturorë sesa nga faktorët joformalë. Ne vazhdojmë ende të kemi nivele të larta të investimeve të huaja dhe vazhdojmë ende të kemi një nivel të rritur të eksporteve shqiptare. Eksportet shqiptare, pavarësisht ndikimit negativ që

dha mbiçmimi i kursit të këmbimit, rezultuan me rritje. Kjo tregon rritje në ekonominë shqiptare, gjallërimin e ekonomisë shqiptare, si dhe vazhdimin e rritjes së ekonomisë.

Gjithashtu, ne kemi pasur të ardhura të mëdha edhe nga reminitancat dhe nga turizmi. Të gjithë këto elemente strukturore, formale dhe fundamentale ndikojnë në kursin e këmbimit dhe vazhdojnë ta mbajnë atë të mbiçmuar. Ne duhet të shikojmë nëse ky kurs që po vlerësojmë këtu ndikon edhe në faktorin kohor, sepse ky është një ekuilibër i ri i kursit të këmbimit, apo jo? Me sa duket mbiçmimi kohor, që ka filluar nga viti 2015 tregon një ekuilibër të ri të kursit të këmbimit. Natyrisht, duke iu referuar eksporteve, do të donim që të kishim një kurs të lirë, të luhatshëm, por ndoshta jo kaq shumë të mbiçmuar. Megjithatë kjo është për t'u vlerësuar dhe për t'u parë, sepse nëse ky është vërtet ekuilibri i ri i kursit të këmbimit, atëherë kjo tregon reflektimin e kursit në ekonominë shqiptare. Gjithsesi, kjo është për t'u vlerësuar në analizën kohore, ku me sa duket faktorët strukturorë dominojnë mbi faktorët joformalë.

Lidhur me nivelin e borxhit dhe strategjinë e financimit të borxhit publik, në radhë të parë, Banka e Shqipërisë, sikurse Kuvendi dhe qeveria shqiptare, kanë rekomanduar dhe orientimi është drejt konsolidimit fiskal, ne synojmë që të kemi një ulje të nivelit të borxhit publik. Kjo gjë do të rrisë fleksibilitetin dhe konkurueshmërinë në ekonominë shqiptare, duke e bërë atë më atraktive ndaj investitorëve të huaj dhe më seriozë.

Gjithashtu, ka përpjekje dhe tendenca kundrejt konsolidimit fiskal dhe uljes së borxhit publik, sikurse ne theksuam. Ajo që dua të them lidhur me strategjinë e borxhit publik është se ne do të preferonim të kishim një huamarrje të orientuar më shumë ndaj monedhës vendase se sa ndaj monedhës së huaj. Kjo do të shmangte riskun e këmbimit valutor në të ardhmen në rast se ne do të kishim një nënçmim të monedhës vendase dhe mbiçmim të monedhës së huaj, në të cilën merret borxhi. Sigurisht, borxhi ka afate më të gjata dhe ne nuk dimë se si do të jetë kursi i këmbimeve pas 5 apo 7 vjetësh, dhe kjo paraqet një risk në riparimin e borxhit. Ne do të preferonim që në lidhje me borxhin të shfrytëzoheshin më shumë burimet vendase se sa burimet e huaja, pasi kjo do të shmangte riskun e refinancimit për borxhin publik.

Këto janë disa elemente që ne do të preferonim lidhur me borxhin. Gjithashtu, ne do të donim që të kishim një borxh me një maturitet më të gjatë se sa me maturitet afatshkurtër, pasi në këtë mënyrë ne do të shmangnim riskun e likuiditetit dhe të normave të interesit. Këto elemente bazë parimore ne do të preferonim që t'i kishim në strategjinë e financimit të borxhit publik, por gjithmonë duke shkuar drejt konsolidimit fiskal. Duhet kuptuar se ulja e nivelit të borxhit dhe tendenca e konsolidimit fiskal është një shtrëngesë për financat publike,

është një reagim serioz, pasi investimet publike janë jetike për zhvillimin e ekonomisë. Pra, nga njëra anë, ne duhet të vazhdojmë investimet dhe, nga ana tjetër, duhet të shkojmë drejt konsolidimit dhe uljes së nivelit të borxhit.

Prandaj, ndoshta edhe programet e PPP-ve janë një zgjidhje, të cilat sjellin një të mesme të pjesshme ndërmjet këtyre dy elementeve. Pra, ne duhet që të sigurojmë investimet publike, si dhe të menaxhojmë sistemin e borxhit, por sigurisht që këto investime duhet të jenë të studiara.

Lidhur me pyetjen tuaj të tretë për nivelin e kreditimit, mund të them se ky është një nga shqetësimet tona kryesore apo një nga fokuset tona kryesore si bankë qendrore, sepse niveli i kreditimit ka shumë faktorë kompleks që kanë ndikuar. Në deklaratat tona publike kemi theksuar dy faktorë kryesorë, por ka edhe faktorë të tjerë. Faktorët kryesorë janë: shtrëngimi i politikave dhe i strategjive të riskut nga bankat e huaja. Sektori ynë bankar, para kreditimit, sigurohet nga sektori financiar dhe sektori ynë financiar është mbi 90% i predominuar nga sektori bankar dhe sektori bankar është i predominuar nga bankat e huaja, kryesisht bankat europiane. Këto banka kanë pasur kriza politike të shtrënguara në drejtim të riskut dhe kreditimit. Strategjitë e tyre nuk kanë qenë aq proaktive, siç mund të kenë qenë para krizës, dhe kjo ka ndikuar në oreksin e tyre për kreditim. Paralelisht ka pasur edhe një kërkesë të ulët agregate, që lidhet kryesisht me projektet e mëdha pasi bankat kanë vazhduar kreditimin. Siç e kemi theksuar, kreditimi ka ardhur në rritje, por me rritje të moderuar, e cila ndoshta nuk i është përgjigjur nivelit të kërkesës tonë për rritjen e ekonomisë shqiptare. Ka edhe faktorë të tjerë ku sistemi bankar ka qenë në evoluim të vazhdueshëm si pasojë e politikave dhe strategjive të disa bankave europiane për t'u tërhequr nga rajoni si pasojë e kushteve shtrënguese nga Banka Qendrore Europiane, pasi kanë pasur problemet e tyre financiare, kanë kaluar në një politikë tkurrjeje. Ndaj, ata kanë parë të arsyeshme të shtonin kapitalin dhe të vazhdonin biznesin në vendet ku kanë pasur filialet e tyre ose do të detyroheshin të mbyllnin degët. Sigurisht, disa nga bankat e mëdha europiane, sikurse ne i kemi parë, kanë vendosur që të tërhiqen nga rajoni, pra jo vetëm nga Shqipëria. Madje, duhet thënë se në Shqipëri shumica e këtyre bankave kanë pasur një performancë shumë më të mirë se sa në shtetet e tjera, kanë qenë me përfitueshmëri, por vendimmarrja ka qenë strategjike në nivel grupi. Kjo ka krijuar një vëmendje të shtuar nga ana e mbikëqyrjes sonë si bankë qendrore, sepse ky proces ka vite që ka filluar. Unë e kam theksuar që në fillim se këto procese do të kërkonin përthithje dhe bashkime, *absorption and mergers*, në sistemin financiar, siç ka ndodhur në shumë vende të tjera. Ky ka qenë një element, që ka deformuar ose shpërqendruar vëmendjen e strategjive të bankave të nivelit të dytë për kreditim, pasi ato

kanë qenë të fokusuara më shumë në bashkim dhe në përthithje se sa në kreditim. Me lëvizjet fundit që kanë ndodhur në tregun financiar shqiptar marrëveshjet kryesore për shitjet e bankave pothuajse janë mbyllur. Ato nuk janë mbyllur ligjërisht pasi ne, Banka e Shqipërisë, jemi ende në procesin e analizës për të pasur një vendimmarrje në përputhje me ligjin dhe rregulloren, por me sa duket, në perspektivë, në vitin 2019 ne do t'i kemi mbyllur kryesisht këto procese, në funksion të ligjit dhe të rregullores. Kjo shpresoj se do të sjellë një element tjetër, që do të ndikojë në rritjen e kreditimit në ekonomi. Këto janë elementet kryesore që kanë ndikuar për të pasur një kreditim jo shumë të lartë, ashtu siç ne e kërkojmë. Sigurisht, duhet theksuar se kreditimi ka vazhduar dhe ne kemi pasur një rritje të moderuar, por në analizën e kreditimit ka ndikuar edhe mbiçmimi i kursit të këmbimit, pasi në portofol ne fusim edhe mbiçmimin e kursit të këmbimit; ndikon fashoja e kredive nga bilanci, pasi kjo gjë ul tepricën e kredisë në total dhe shfaq një rritje më të ulët të kreditimit, që, në fakt, nuk është ashtu, por është një tregues që ndikon në tepricën e kredisë. Gjithashtu, në nivelin e kreditimit ndikojnë edhe elemente të tjera, për shembull, vetëm kredia e BERZH-it këtë vit ishte 118 milionë euro. Natyrisht, kredia për ekonominë nuk ka ndryshuar, mbetet e njëjtë, por për shifrat që themi për nivelin e kreditimit ne u referohemi bankave. Kështu, duket sikur ka rënë niveli i kreditimit, sikur ka një lëvizje dhe një transferim të kredisë nga sistemi bankar te Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila nuk është pjesë e pasqyrave tona financiare kur raportojmë nivelin e kreditimit, por niveli i kreditimit në ekonomi përfshin edhe këtë lloj kredie. Ne shpresojmë që, me ndryshimet në sistemin financiar dhe sistemin bankar shqiptar, do të ketë një orientim dhe një oreks më të rritur nga ana e bankave të nivelit të dytë për kreditim. Gjithashtu, ne po presim të mbyllen këto marrëveshje për të thënë përfundimisht formatimin e ri të tregut, por me sa duket, me parashikimin ose me atë që ne po shikojmë, do të kemi një konsolidim të sistemit bankar, që ka qenë një nga objektivat tona. Pra, vitin e ardhshëm ne po presim që të kemi 13 banka në vend të 16 dhe kjo do të jetë më e shëndetshme për konkurrencën në sistemin bankar. Pesha që do të kenë një numër bankash në sistemin bankar do të jetë pothuajse e barabartë, ose me ndryshime shumë të vogla, në raport me bankat e nivelit të mesëm. Pra, një numër i caktuar bankash do të kenë një peshë specifike shumë të përafërt, rreth 5% ose 5,5%. Kjo të rrisë konkurrencën e këtyre bankave për të pasur një konkurrencë të shëndetshme drejt rritjes së biznesit bankar. Sigurisht, ne presim që gjithashtu kjo të ketë ndikim pozitiv në kreditim.

Pyetja juaj e katërt kishte të bënte me risqet financiare që ka ekonomia shqiptare. Natyrisht që ekonomia ka shumë risqe dhe përballet me shumë sfida. Pavarësisht se ka ardhur në rritje, ne vazhdimisht e kemi theksuar se balanca e risqeve mbetet në kahun e poshtëm dhe

kjo tregon se ende ka risqe, të cilat cenojnë qëndrueshmërinë jo vetëm të financave publike, por edhe të rritjes ekonomike.

Në radhë të parë, dua të them se ne duhet të shikojmë si risk goditjet që vijnë nga ekonomitë e huaja. Shqipëria është një vend, i cili partnerët e saj tregtarë kryesorë i ka në vendet e eurozonës. Në qoftë se ne do të kemi një rritje ekonomike në eurozonë, kryesisht në shtetet që kemi më shumë bashkëpunime tregtare dhe investime të huaja direkte, si: Italia, Greqia, Gjermania dhe shtete të tjera të eurozonës, sigurisht që këto do të reflektoheshin pozitivisht në ekonominë shqiptare. Në rast se ne do të kishim një përmirësim të ekonomive të këtyre vendeve, siç ishte kriza ekonomisë greke apo situata e vështirë ekonomike në Itali, atëherë këto do të krijojnë ndikimin e tyre negativ në ekonominë shqiptare, si në rritjen e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, si dhe të elementeve të tjera, të cilat ekonomia jonë është e ndërthurur. Ne kemi një ekonomi totalisht e hapur kundrejt tregjeve ndërkombëtare dhe tregjeve të eurozonës, ndaj këto janë disa risqe, që ne i shikojmë prezente në ekonominë shqiptare. Prandaj, ne synojmë që të kemi një tkurrje dhe një regjim të lirë të kursit të këmbimit, në mënyrë që ekonomia jonë të jetë sa më fleksibël ndaj goditjeve.

Gjithashtu, kemi edhe risqe që kanë të bëjnë me ambientin e brendshëm. Risku kryesor në lidhje me ambientin e brendshëm është serioziteti dhe vazhdimi i reformave strukture. Natyrisht, ne nuk duhet të ulim nivelin e reformave strukture. Ekonomia shqiptare ndodhet në një moment pozitiv të rritjes, të zhvillimit dhe nuk duhet humbur ky moment, por reformat duhen vazhduar me shpejtësi. Ne kemi një set reformash, siç është aktualisht reforma në drejtësi, por edhe reforma të tjera, të cilat janë ndërmarrë. Këto reforma duhen vazhduar me të njëjtin intensitet, për të mos humbur momentin pozitiv të ekonomisë shqiptare.

Banka e Shqipërisë nga ana e saj përpiqet që, kundrejt kuadrit të saj ligjor dhe rregullator, të vazhdojë me reformat e saj në lidhje me stimulimin e kreditimit, me përmirësimin e sistemeve të pagesave, me modernizimin e sistemeve të pagesave, me procesin e formalizmit të ekonomisë. Ne kemi marrë një masë lidhur me informalitetin, si një nga problemet kryesore të ekonomisë shqiptare.

Reforma, në kuadrin e informalitetit, është një nga elementet kryesore, të cilën kemi vendosur ta ndërmarrim edhe në bashkëpunim me qeverinë shqiptare. Sigurisht edhe kjo ka pasoja, pasi fillimet e kësaj reforme kanë dhënë disa goditje negative në ekonomi, por në vazhdimësi kjo rrit konkurueshmërinë dhe zbatimi i ligjit ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike. Vetëm në aspektin e kreditimit, po ta lidhim reformën kundër informalitetit, ne u detyruam të ndërmarrim një masë, duke përforcuar në rregulloren tonë kërkesat që bankat

kreditojnë bilance fiskale dhe jo me pasqyra joformale financiare. Sigurisht, deri në një moment të caktuar bankat ishin të detyruara të pranonin edhe bilance joformale, pasi ky ishte realiteti shqiptar. Kjo masë ka ndikuar fillimisht në procesin e kredithënies, por kjo i përket një periudhe kohore afatgjatë, pasi do të edukohet tregu, do të edukohen bizneset, gjithashtu do të gjendet edhe gjuha e përbashkët ndërmjet bankave dhe bizneseve për të proceduar në mënyrë formale.

Këto janë ato që unë do të thosha në vija të përgjithshme, pasi ka edhe shumë risqe të tjera, që nuk do të doja t'i lista, por në vija kryesore unë do të shikoja risqet që vijnë nga tregu i jashtëm dhe vazhdimin e reformave strukturore në ekonominë shqiptare.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zoti Xhakolli.

Ilir Xhakolli – Unë dua të bëj një pyetje lidhur me investimet e huaja, megjithëse po të krahasojmë 6-mujorin e parë të vitit 2018 me vitin 2017 kemi 28% rritje. Meqenëse investimet e huaja janë një nga faktorët kryesorë që garantojnë rritjen ekonomike, çfarë duhet të bëjmë ne për të rritur më shumë investimet e huaja në Shqipëri?

Gent Sejko – Faleminderit, zoti Xhakolli!

Investimet e huaja janë një nga prioritetet, objektivat dhe sfidat tona për rritjen e ekonomisë. Ne patjetër duhet të punojmë gjithmonë e më shumë për rritjen e investimeve të huaja, pasi për momentin ne kemi një nivel të lartë të investimeve të huaja. Përqindja kryesore vjen nga dy investime të mëdha, të cilat kanë ciklin e tyre dhe vazhdojnë të kenë ndikimin e tyre, por në një moment të caktuar këto investime do të përfundojnë. Natyrisht, të ardhurat nga këto investime në ekonominë shqiptare do të përkthehen në të ardhura më pas nga rimarrja e investimit, por gjithsesi ne kemi nevojë për investime të huaja, ashtu si çdo vend tjetër i rajonit.

Gjithashtu, investimet e brendshme kanë vlerën e tyre. Ekonomia shqiptare është rritur edhe si pasojë e nivelit të lartë të konsumit dhe jo si pasojë e investimeve të brendshme. Investimet e huaja, përveç faktorit të injektimit të kapitalit, kanë edhe një element shumë të rëndësishëm, që është sjellja në vendin tonë të teknologjive dhe të njohurive. Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për kapitalin, por sjell një risi në teknologji të reja dhe zhvillime të reja, për të cilat ka nevojë tregu. Lidhur me investimet e huaja, unë do të thosha se sfida për ne mbetet përmirësimi i klimës së biznesit, që, pavarësisht nga të gjitha reformat e ndërmarra dhe ecurisë pozitive, përsëri ka shumë sfida. Përmirësimi i klimës së biznesit lidhet sidomos

me respektimin e kontratave dhe përmirësimin e aspektit ligjor, si një nga kushtet dhe kriteret kryesore që do të jepte garanci për investimet e huaja.

Natyrisht që investimet e huaja, përveç rregullimit të klimës së biznesit, kanë edhe faktorë të tjerë, që lidhen në mënyrë bazike me sigurinë, me rendin publik, me paketat fiskale, si dhe me qëndrueshmërinë fiskale, që unë e përmenda gjatë fjalës sime. Ne kemi në sistem taksash, i cili është mjaftueshëm i atraktiv, por qëndrueshmëria në paketat fiskale, në sistemin fiskal, në ndryshimet e shpeshta, në ndryshimet e rregullave të lojës dhe gjatë lojës nuk do të ishin të mira për investitorët. Sa më e qëndrueshme të jetë paketa fiskale, aq më seriozë do të jemi në kundërt investitorëve të huaj. Natyrisht, investimet e huaja ndikojnë edhe në madhësinë e tregut. Ky është një faktor objektiv, i cili nuk është në dorën tonë, madhësia e tregut është ajo që kemi. Ajo që na takon ne është të jemi seriozë, të bëjmë detyrat tona lidhur me përmirësimin e këtij lloj biznesi, lidhur me propagandimin ose marketingun e aseteve tona si Shqipëri, lidhur me përmirësimin e fuqisë punëtore.

Një problem tjetër që ndikon në investimet e huaja është niveli i kualifikimit të fuqisë punëtore, prandaj dhe një nga reformat në edukim ka qenë ajo për të orientuar brezat e rinj kundërt shkollave profesionale, në mënyrë që të kemi një fuqi punëtore sa më të kualifikuar kundërt investimeve të huaja direkte vetëm me ekonomistë dhe juristë ose me shkencëtarë. Nuk arrijmë dot që t'i furnizojmë apo t'u përshtatemi investitorëve të huaj. Duhet të kemi fuqi punëtore sa më të kualifikuar, sipas sektorëve të ekonomisë. Duhet të bëhet një riorientim i trajnimit ose i edukimit të fuqisë punëtore kundërt sektorëve potencialë të ekonomisë, që i dimë se cilët janë: turizmi, bujqësia, mineralet dhe fuqinë punëtore duhet ta kualifikojmë në këtë drejtim.

Këto janë elemente bazike dhe kryesore për tërheqjen e investimeve të huaja, por duhet të kihet parasysh që është një sfidë e madhe, pasi po ta shikojmë vetëm nga pikëpamja e sistemit financiar, për të cilin ne jemi rregullatorë, një nga streset tona të mëdha që përmenda ka qenë tërheqja e disa investitorëve të huaj, si pasojë e krizës në eurozonë. Tërheqja ka qenë nga i gjithë rajoni, jo nga Shqipëria. Ne jemi tregje të fragmentuara: Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi jemi shtete të rregulluara, kemi potenciale të mëdha, por jemi tregje të vogla. Një nga përpjekjet e mëdha në rang rajonal është që të arrijmë të jemi një treg i unifikuar i përbashkët, por edhe kjo ka shumë sfida. Po punohet drejt saj dhe investimet e huaja do të kishin më shumë vëmendje, pasi bëhet fjalë që ne të jemi në gjendje të tërheqim kompani, korporata të mëdha, të cilat sjellin kapital, sjellin risi teknologjike.

Faleminderit!

Erion Braçe - Faleminderit!

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Guvernator për opinionet, mendimet dhe sugjerimet tuaja në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2019!

Në vijim të opinionit tuaj, më lejoni të bëj disa pyetje.

E para, çfarë po ndodh me ristrukturimin e sektorit bankar? Çfarë sfidash dhe oportunitetesh do të sjellë ai për vendin?

E dyta, sipas opinionit tuaj: si e shikoni ecurinë ekonomisë dhe në funksion të saj politikën monetare dhe atë fiskale, sepse dihet nëse këto politika shkojnë bashkë, do të kemi një stabilitet financiar?

E treta, cilat duhet të jenë prioritetet e reformës strukturore në vend dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit?

Gent Sejko –Faleminderit, zonja Dhima!

Lidhur me ristrukturimin e sektorit bankar dhe sfidat që ka, e përmenda pak. Më konkretisht do të thosha se ristrukturimi i sektorit bankar është një nga elementet kryesore dhe faktorët që po merr kohën dhe energjitë kryesore të institucionit tonë si bankë qendrore, pasi disa banka kanë qenë në procese të ndryshimit të aksionerëve.

Një nga objektivat tona ka qenë konsolidimi i sistemit, pasi numri i bankave që kanë operuar në Republikën e Shqipërisë ka qenë sipas disa studimeve relativisht i lartë, pavarësisht se ne kemi pasur përqendrim në qytete dhe kemi dashur të mbulojmë edhe zonat rurale, por kjo lidhet edhe me strategjitë që kanë pasur bankat komerciale nga ana e tyre. Jo të gjitha bankat kanë pasur të njëjtin impakt në ekonominë shqiptare. Kemi pasur banka të mëdha, të mesme dhe të vogla, disa banka ka shumë vite dhe më herët që kanë qenë jo aktive, nuk kanë ndikuar mjaftueshëm, disa banka kanë qenë më proaktive dhe kriza në eurozonë i ka detyruar disa banka të tërhiqen, të marrin vendim për mbyllje. Ne si bankë qendrore kemi ngulur këmbë dhe jemi përpjekur në maksimum, jo vetëm të zbatojmë kërkesat ligjore dhe rregullatore në këtë proces, por të bëjmë edhe një punë në drejtim të tërheqjes së grupeve të mëdha bankare, për të zëvendësuar aksionerët. Gjatë kësaj kohe jemi përpjekur shumë duke kontraktuar vazhdimisht grupe të mëdha bankare për t'i treguar potencialet e tregut shqiptar, sepse realisht shumica e bankave, pothuajse shumica e bankave janë me përfitueshmëri, por treguesit e përfitueshmërisë, likuiditetit dhe kapitalit kanë mbetur në nivele të kënaqshme edhe pas krizës dhe duke pasur parasysh humbjet që bankat kanë krijuar, kanë pësuar nga niveli i lartë i kredive me probleme, përsëri ato kanë

pasur rezerva fondesh për të mbuluar humbjet dhe për të vazhduar biznesin e tyre me përfitueshmëri në këtë situatë që paraqet tregu shqiptar edhe ka ende potenciale. Ne e njohim tregun mirë dhe jemi përpjekur që ta prezantojmë këtë treg. Por kjo ka të bëjë me madhësinë e tregut. Ne përsëri duhet të themi se me gjithë këto sfida dhe krahasimisht me shtetet e tjera duhet të jemi të kënaqur, pasi kemi vazhduar të ndryshojmë në treg aksionerë europianë, pra po marr shembullin e Bankës Veneto, këto janë të publikuara, e cila u përthith nga Banka Intesa. Jemi njohur dhe kemi marrë aplikimin, jemi në proces shqyrtimi. Kjo nuk do të thotë që është miratuar, por *Banka Societe Generale* që u tërhoq nga tregu ka hyrë në negociata me bankën hungareze OTP që është banka më e madhe në Hungari. Hungaria është një vend i BE-së dhe kjo është një nga bankat më të vjetra. Në tregues dhe në banka të tjera ka një bashkim midis disa bankave në tregun shqiptar. Ky është një element shumë pozitiv dhe ky ristrukturim e rritet edhe një herë presim që të ndikojë pozitivisht në rritjen e kreditimit dhe në rritjen e konkurrueshmërisë në tregun bankar shqiptar në vitin 2019. Në rast se ne nuk do të kemi goditje negative nga jashtë dhe elementë të tjerë, të cilët vijnë nga jashtë dhe janë të pamënaxhueshëm nga ekonomia e brendshme, ne jemi të bindur dhe parashikimet tona garantojnë se sistemi bankar do të jetë më i orientuar drejt kreditimit në vitin 2019 dhe në vazhdim. Në afatmesëm ne do të kemi një rritje të konkurrencës dhe rritje të kreditimit, pas ristrukturimit të sektorit bankar. Fatmirësisht ristrukturimi i sektorit bankar ka pasur një ecuri më pozitive sesa kemi menduar në fillimet e këtij procesi. Kemi qenë me më pak shpresë për cilësinë e aksionerëve, gjithmonë duhet pasur parasysh se grupe të mëdha bankare pas krizës nuk kanë pasur vëmendje, kjo duhet të pranohet në të gjithë rajonin tonë. Ne kemi kontaktuar vazhdimisht në mbledhjet tona, sidomos në mbledhjet vjetore me FMN-në dhe me grupe të tjera ku janë prezente edhe grupet e mëdha bankare. Kemi parë mungesë interesi, kemi ngritur grupe pune, siç është *Vienna iniciatave* dhe grupe të tjera pune me mbështetjen e FMN-së, për të qenë sa më atraktivë për të prezantuar resurset e ekonomive tona, jo vetëm si Shqipëria, por situata është e tillë, duhet të jemi të qartë se grupet e mëdha bankare kanë pasur shqetësimet e tyre. Janë marrë kontakte jo vetëm me guvernatorët e rajonit, pa diskutim, se ne jemi si një skuadër, por edhe me guvernatorët e shteteve më të mëdha si: Franca, Gjermania, Turqia dhe me radhë, që të mos i listoj, në mënyrë që ne të tërheqim sa më shumë banka, grupe të mëdha bankare serioze në Shqipëri. Ne flasim për Shqipërinë, rajoni menaxhohet nga rregullatorët respektivë.

Dua të them se situata ka ecur më pozitivisht, është në kontroll, thjesht ne do të zbatojmë kërkesat e ligjit, kërkesat rregullatore në ristrukturimin e sistemit bankar.

Faleminderit për këtë pyetje!

Në lidhje me pyetjen e dytë, për ecurinë e ekonomisë shqiptare, unë e përmenda, ajo që dua të theksoj është se duhet të vazhdojmë të mbajmë një miks, politika është ekonomike, të një politike monetare lehtësuese dhe politikës fiskale konsoliduese. Ky është miks i nevojshëm që siguron rritjen ekonomike dhe përshpejtimin ekonomik, por sikurse edhe eurozona parashikimet janë se ekonomi do të vijë drejt përmirësimit, ekonomia shqiptare do të ketë rritje më të lartë, pasi ne jemi një ekonomi në zhvillim në terma shifër, sesa eurozona sipas parashikimit. Politika jonë monetare lehtësuese duhet të vazhdojë edhe për një periudhë kohore, por në afatgjatë ne duhet të kalojmë nga politika monetare lehtësuese në një politikë monetare shtrënguese. Në rast se ne do të vazhdojmë sikurse e kemi parashikuar të kemi një rritje ekonomike, atëherë në harkun e një viti apo më pas, duhet të rishikojmë dhe gradualisht të kalojmë në një politikë monetare shtrënguese, e cila do të thotë që ne mund të vazhdojmë me rritjen e normave të interesit. Kjo është për t'u parë. Në rast se të gjitha risqet nuk do të kenë goditje, por do të kenë goditje të parashikuara, për momentin do të thosha se ne duhet të vazhdojmë me koordinimin e miksit aktual të politikave, të politikës fiskale konsoliduese me politikën monetare lehtësuese.

Prioritetet e reformave strukturore, për sa i përket kësaj pyetje, unë përmenda diçka, ne kemi parasysh dy elemente kryesore lidhur me reformat strukturore në parim, që së pari ato të nxin zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit. Së dyti të rritet qëndrueshmëria e ekonomisë sonë ndaj goditjeve të huaja dhe të brendshme. Reformat strukturore lidhen me shumë elemente të ekonomisë, ka një listë, janë disa prioritet, janë përcaktuar prioritetet e reformës strukturore dhe janë ndjekur. Ato kanë të bëjnë me ato që thashë më lart, nuk do të doja që t'i përsërisja: me përmirësimin e infrastrukturës, me përmirësimin e teknologjisë, me përmirësimin e klimës së biznesit, me rritjen e kualifikimit të fuqisë punëtore dhe me të gjithë elementet e tjera që e bëjnë një vend atraktiv për investimet e huaja direkte, por dhe sigurojnë terrenin ligjor rregullator dhe kompetitiv për rritjen e ekonomisë. Duhet të mos humbim momentin pozitiv që po kalon ekonomia shqiptare për vazhdimin dhe përshpejtimin e reformës strukturore. Kjo është shumë e rëndësishme.

Erion Braçe - Po, zoti Pëllumbi.

Do t'ju lutesha që të fokusohemi te buxheti. Kjo është seancë për marrjen e opinionit për buxhetin, jo për sistemin bankar.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit Guvernator që jeni sot i pranishëm për të ndarë me ne mendimet e Bankës së Shqipërisë dhe këndvështrimet e saj në lidhje me buxhetin e vitit 2019!

Ne gjykojmë se Banka e Shqipërisë sot në opinionin e të gjithëve është një nga institucionet më të besueshme dhe më të pavarura, pra edhe pozicioni juaj në lidhje me buxhetin është i rëndësishëm për ne.

Më vjen mirë të evidentoj që pak a shumë në vija të përgjithshme të buxhetit, pozicioni juaj është i njëjtë me atë të Komisionit të Ekonomisë dhe në përgjithësi të maxhorancës, si një buxhet, i cili është realist dhe arrin të sigurojë jo vetëm rritje ekonomike, por edhe stabilitetin e treguesve kryesorë ekonomikë të vendit dhe të garantojë uljen e papunësisë.

Unë duke përfituar nga prezenca juaj sot, dua t'i kthehem edhe një herë një diskutimi që ne kemi filluar ta bëjmë në fillim të këtij viti, kur kishim prezent edhe opozitën në komision në lidhje me kursin e këmbimit. Të gjithë e kujtojnë se ngulej këmbë se ishin faktorët informalë ata që ndikonin në kursin e këmbimit dhe jo faktorët strukturorë. Sot në gjuhën e kujtudo, përfshirë edhe të opozitës fjala “kanabis” është zhdukur dhe megjithatë kursi i këmbimit, leku ka këtë peshë që ka pasur që nga fillimi i këtij viti.

Më vjen mirë që dëgjova nga ju se janë faktorët strukturorë ato që kanë ndikuar në këtë kurs konvertimi dhe me sa duket ekonomia shqiptare po imponon një kurs të ri të këmbimit të lekut.

Më kujtohet se kemi folur edhe për një proces tjetër, i cili nuk u përmend dhe për këtë do të doja t'ju pyesja, për procesin e deurozimit, si është duke vazhduar ky proces? A është futur ai në rrjedhën e tij normale?

Gent Sejko - Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Lidhur me kursin e këmbimit unë i bëra komentet, edhe ju komentuat. Faktori kohor, koha gjithmonë dhe më shumë do të na bindë, analizat tona janë lidhur me ato konkluzione që thashë. Ne kemi informacion formal, zyrtar, i cili tregon për ndikimin e faktorëve strukturorë në forcimin e kursit të këmbimit. Ju rikujtoj se kursi i këmbimit ka filluar mbiçmimin e tij nga vitet 2015. Po të shikojmë ecurinë e rritjes së forcimit të ekonomisë shqiptare dhe ritmin e mbiçmimit të kursit të këmbimit ato shkojnë paralelisht. Kjo do të thotë se, në mënyrë të padiskutueshme faktorët strukturorë, faktorët fundamentalë kanë ndikim në ecurinë e kursit të këmbimit, pasi treguesit formalë të certifikuar tregojnë një rritje të eksporteve, rritje të investimeve të huaja direkte dhe rritje të sektorit të turizmit. Ne jemi ekonomi e hapur, e integruar me eurozonën dhe euroja është monedha kryesore, e cila hyn në ekonominë shqiptare dhe aktiviteti tregtar, investimet e huaja kryen me këtë monedhë. Një shtet i vogël si Shqipëria do të kishte një ndikim patjetër në drejtim të kursit të këmbimit duke qenë kaq e hapur kundrejt tregjeve të huaja. Por këtu ka shumë risqe. Nuk

do të doja të zgjatesha në këtë komision, por është mirë kur kemi investime, flukse hyrëse. Do të ishte mirë në rast se do të kishim një ekuilibër të ri të kursit të këmbimit me një lek të mbiçmuar, pasi kjo tregon në fund të fundit, sipas parimeve makro-ekonomike rritje të fuqisë blerëse, për sa kohë që ne kemi një nivel të lartë të eurozimit të ekonomisë shqiptare.

Në sektorin financiar ne kemi mbi 50% në krahun e aktivëve dhe të pasivëve, kemi mbi 50% kredi në euro dhe mbi 50% kredi në depozita. Kjo tregon sesa i lartë është ekspozimi në sektorin financiar në nivelin e eurozimit. Kjo paraqet risk. Ky risk është i shpërndarë sipas kategorive të ndryshme qoftë të individëve, qoftë të biznesit. Ata individë, të cilët i kanë të ardhurat në euro, humbasin dhe shpenzimet në lekë, por ata individë, të cilët i kanë të ardhurat në monedha vendase, në lekë dhe mund të kryhen shpenzime në euro fitojnë.

E njëjta gjë është edhe për bizneset. Ne jemi një vend me deficit tregtar, që do të thotë se kemi më shumë importues sesa eksportues dhe në këtë situatë për momentin kjo tregon se në total ekonomia ka më shumë përfitim. Por nga ana tjetër ka disa raporte, janë raporte shumë specifike, të cilat i ndjekim, eksportet janë lokomotivë e ekonomisë shqiptare, ne duam të rrisim eksportet dhe mbiçmimi i kursit të këmbimit ndikon negativisht tek eksportet. Ky klasifikohet element negativ i ekonomisë shqiptare. Këtu ka shumë elemente, të cilat i marrim parasysh, i realizojmë dhe shikojmë efektet, ndikimet. Natyrisht siç e shpjegova në fillim të fjalës sime ndërhyrjet janë të përcaktuara sipas politikave strategjike. Banka e Shqipërisë nuk ndërhyr për të mbrojtur grupe të caktuara të interesit, për sa kohë ne kemi një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Banka e Shqipërisë ndërhyr vetëm kur ka çrregullimi ose mbiçmime jo normale të kursit të këmbimit që ndikojnë në nivelin e inflacionit. Inflacioni është objektivi ynë kryesor, atëherë mbiçmimi i kursit të këmbimit i përshpejtuar si pasojë e faktorëve jofondamentalë i pritshmërive të ndryshme do të godiste nivelin e inflacionit dhe ne jemi të detyruar që të ndërhyjmë. Kjo është një filozofi që ndjekin të gjitha bankat qendrore.

Lidhur me deurozimin, në këtë situatë të një niveli kaq të lartë deurozimi, sikurse edhe shtete të tjera edhe ne kemi qenë të detyruar të marrim disa masa për të ulur dominancën e euros në ekonomi. Kjo nuk do të thotë se ne kemi marrë masa për të forcuar lekun në raport me kursin. Duhet të kuptohet, pasi shpeshherë keqkuptohet dhe ngatërrohet. Nuk ka lidhje fare. Masat janë për të ulur nivelin e ekspozimeve në euro. Për shembull nëse ju keni të ardhurat në euro, nuk kemi pse të merrni të ardhurat në lekë, monedhën vendase, nuk keni pse të merrni kredi në euro. Kjo ka qenë masa edukative, sepse ju ekspozoheni ndaj rrezikut, kursit të këmbimit, të ardhurat në lekë, kredia në lekë, atëherë pse duhet të

marr kredinë në euro? Nesër, sidomos kreditë individuale janë afatgjata, ju ekspozoheni kundrejt një rreziku që nuk do të jeni në gjendje të shlyeni kredinë. Këto kanë qenë masat tona, masa për të edukuar publikun, por edhe për disa ndryshime të papërfillshme në rezervat e detyrueshme që mban banka qendrore në raport me sistemin financiar, që janë bërë në marrëveshje me sistemin bankar. Ka pasur shumë sensitivitet, është keqkuptuar, nuk janë kuptuar masat e bankës qendrore. Ne jemi përpjekur t'i shpjegojmë, i kemi shpjeguar, kemi bërë një komunikim të vazhdueshëm, por shpeshherë është e vështirë për të kuptuar instrumentet e bankës qendrore nga agjentët e tregut. Agjentët e tregut janë sensitivë, sidomos në rastin konkret eksportuesit, sepse ata që fitojnë importuesit nuk flasin, por përfitojnë. Ai që është mirë nuk flet, ai që është keq, flet. Në rastin konkret ne jemi përballur, e kemi shpjeguar, dekurazimi duhet të vazhdojë si proces jo vetëm në aspektin financiar, sikurse e shikojmë edhe në shtete të tjera, duhet të vazhdojë edhe në ekonominë reale, në ato raste që është e panevojshme të ketë transaksione në monedhë të huaj. Pse duhet të bëhet veprimi në monedhë të huaj? Nuk flasim për eksportuesit ose importuesit që bëjnë aktivitet me tregjet ndërkombëtare, por shitja e produkteve shqiptare, tregu shqiptar duhet të funksionojë në lekë. Pse duhet të funksionojnë raste të panevojshme, që nuk ka logjikë? Nuk dua të zgjatem, por ka një strategji, ka një praktikë. Nuk kemi shpikur asgjë, çdo gjë është adoptuar dhe është marrë duke parë ekonominë që kanë kaluar cikle, pothuajse të ngjashme me ekonominë shqiptare. Këtë kemi bërë.

Erion Braçe - Po, zoti Beqiraj.

Do t'ju lutem që të fokusohemi te buxheti, edhe një herë tjetër!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Kam 2-3 pyetje, një pjesë të së cilave ju i keni konsumuar, por këto edhe për publikun. Unë do të rikthehem në një zhurnajë që është bërë nga gjysma jonë që mungon edhe në këtë komision edhe gjatë diskutimit të projektbuxhetit lidhur me investimet publike që janë parashikuar në buxhetin e vitit 2019. Ky vit shënon një kulm. Unë do të përqendrohem në partneritetin privat-publik. Në opinionin tuaj dhe të Bankës së Shqipërisë që ju përfaqësoni përbën risk për bankat e nivelit të dytë dhe për sistemin financiar në tërësi? Në terma më të qarta që ta kuptojnë edhe të tjerët që të mos bëhet politikë në boshllëk vetëm për të hedhur baltë, por në rritjen e borxhit publik në përgjithësi.

Lidhur me pyetjen e dytë, transferimi i kapitaleve financiare nga Shqipëria, a ka ndikuar në klimën e biznesit dhe të financave për vitin 2018 dhe përbën risk për vitin 2019 dhe në vazhdim?

Edhe unë bashkohem me shqetësimin që kolegët e mi pyetën për ndryshimin e kursit të valutave të huaja, sidomos të euros dhe të dollarit, të cilat japin impakt të paparashikueshëm në planifikimin buxhetor. Në opinionin e Bankës së Shqipërisë, a mos ka ardhur koha e ndryshimit të lekut dhe përdorimit të euros?

Gent Sejko- Faleminderit!

Lidhur me investimet publike, kemi thënë se Shqipëria ka shumë nevojë për to, është një vend që ka nevojë jetike për investimet publike. Jo vetëm ne, si bankë publike, por jo është një dakordësi e të gjithë faktorëve ekonomikë e politikë.

Natyrisht, projektet e partneritetit publik privat janë një nga mënyrat për të kryer këto investime publike. Për sa kohë që projektet e partneritetit publik privat janë brenda normave të përcaktuara, sikurse limitet e tavaneve në buxhetin e shtetit, dhe nuk i tejkalojnë këto limite, atëherë do të ishin të mirëmenaxhuara.

Këtu ka një risk të caktuar, pasi këto projekte kanë të bëjnë kryesisht me investime në infrastrukturë, në rrugë, në lidhje me të cilat askush nuk është i sigurtë nëse projekti do të ketë strukturimin dhe investimin e përcaktuar. Shpeshherë projektet infrastrukturore, gjatë rrugës kanë nevoja shtesë, gjë e cila e komplikon projektin. Prandaj duhet bërë një projekt sa më i studiuar. Pikërisht për këtë arsye, ne i kemi sugjeruar qeverisë shqiptare që të rrisë kapacitetet teknike e financiare në analizimin dhe përgatitjen e këtyre projekteve të partneritetit publik privat. Sa më lart të jetë ekspertiza në trajtimin e projekteve të partneritetit publik privat, aq më të kontrolluara do të jenë këto projekte, aq më pak surpriza do të sjellin gjatë rrugës, gjatë kohës së investimit.

Nga i njëjti këndvështrim do të flisja edhe lidhur me bankat. Bankat duhet ta bëjnë analizën ashtu siç është analiza e kredisë për një projekt të caktuar, si analiza e një projekti publik privat. Në qoftë se bankat do të shohin se projekti është fizibël, nëse paraqitet me nivel profesional dhe është *bancable*, pra është i pranueshëm, për t'u kredituar, banka do ta kreditojë. Bankat kanë ekspertët e tyre. Praktikisht, ç'është e vërteta, bankat kanë një nivel më të lartë ekspertësh, sepse kanë ekspertë ndërkombëtarë, që vijnë nga bankat mëma, kanë vlerësim dhe gjykim për këto projekte.

Bankat në Shqipëri kanë tepriçë likuiditeti. Janë rreth 4 miliardë euro tepriçë likuiditeti, të cilat bankat kanë interes t'i investojnë. Investimi në këto projekte do të kishte përfitueshmëri dhe kthim më të lartë se sa investimi në vendosje me bankat e huaja.

Analiza e riskut është thelbësore. Me një analizë risku lidhur me këto projekte, po të prezantoheshin siç duhet, bankat do të merrnin pjesë. Nuk duhen shkelur parimet e standardet

ndërkombëtare, jo vetëm në kontabilitet por edhe sa i takon analizës së riskut për këto projekte.

Në rast se ne do të vazhdojmë me këto raporte të përcaktuara në buxhet, me një prezantim serioz dhe profesional të projekteve të partneritetit publik privat, ne do të kemi një ecuri normale. Në rast se projektet nuk do të jenë të studiuara, nuk do të ndiqen sipas strategjive të zhvillimit të vendit, pasi kemi një listë me prioritete projektesh. Në rast se do të kemi surpriza gjatë ecurisë së projektit, atëherë do të kemi edhe probleme në borxh, sepse do të kishim kërkesa shtesë për investime në projekt, do të kishim probleme në ecurinë e projektit, në marrëdhënien e projektit me bankat e nivelit të dytë, meqenëse disa projekte do të jenë patjetër në bashkëpunim edhe me bankat.

Lidhur me transferimin e kapitalit jashtë Shqipërisë, nga disa shifra që unë kam parë, sidomos për individët, ne kemi më shumë të hyra se sa të dala jashtë Shqipërisë. natyrisht, disa nga korporata do ta transferojnë dividendin jashtë Shqipërisë, disa e kanë rikapitalizuar. Shpeshherë, investimet e huaja direkte janë rritur, kjo edhe si pasojë e rikapitalizimit dhe riinvestimit të fitimeve nga ana e këtyre korporatave. Pra, nuk kanë qenë vetëm investime në të ardhura, por ka qenë edhe rritja e riinvestimit dhe kapitalizmit. Natyrisht, është mirë që kapitalet të investohen. Ne synojmë që patjetër të investohen në ekonominë shqiptare, se ekonomia ka pasur rritje edhe nga ky element, e jo të transferohen. Nga ana tjetër, shumë korporata do të bëjnë edhe tërheqjen e dividendit. Për momentin nuk e shikojmë si problem që ka ndikuar edhe aq negativisht në ekonominë shqiptare. Nuk është ky problemi.

Lidhur me pyetjen e tretë, ajo përmban një nga elementët më esencialë. Na takon ne si Bankë e Shqipërisë, që nëpërmjet edukimit financiar dhe informimit, të sqarojmë publikun se përse lekë apo euro. Kjo është një pyetje, e cila do të donte kohë për t'u shpjeguar. Ndoshta ne do ta elaborojmë me publikun dhe me këtë parlament të nderuar. Meqë, natyrisht, ka kaq shumë rreziqe në lidhje me kursin e këmbimit, e meqë ne po shkojmë drejt Bashkimit European, ose po tentojmë të aderojmë në Bashkimin European brenda një periudhe kohore të përcaktuar, pse të mos fusim euron dhe t'i shmangim të gjitha këto risqe?

Kjo është një logjikë shumë e thjeshtë. Problemi është se kemi të bëjmë me diçka që është më e komplikuar se kaq. Pikërisht pse duam të shkojmë drejt Bashkimit European dhe duam të vazhdojmë të kemi një ekonomi konkurruese, fleksibël, atraktive ndaj investimeve të huaja e të qëndrueshme, ne duhet të vazhdojmë me monedhën tonë kombëtare. edhe sikur të mos ishin gjithë këta elementë, ne nuk mund të adoptojmë euron, pasi nuk e kemi të lejuar nga Komisioni European. Pra, edhe sikur ne të ishim gati, është e pamundur futja e euros në ekonominë shqiptare. Jo vetëm është e pamundur, por është edhe e papreferuar, pasi kështu

do të humbisnim disa nga avantazhet e ekonomisë, avantazhet tona dhe të përdorimit të instrumenteve të Bankës Qendrore për nxitjen dhe rritjen ekonomike. Nuk do të kishim instrumentin e politikës monetare, i cili është një instrument që përdoret për stimulimin e investimeve, për rritjen ekonomike dhe rritjen e kërkesës.

Gjithashtu, do të kishte deformime dhe shpërpjesëtime në balancat financiare dhe makroekonomike, nëse do të ndodhte, por së pari nuk e kemi të lejuar, dhe së dyti ka shumë risqe, që do ta deformonin ekonominë shqiptare. Së treti, do të humbisnim avantazhet e përdorimit të instrumenteve të politikës monetare, të cilat përdoren pikërisht për këtë qëllim: për të rritur ekonominë, për të rritur konsumin, për të rritur investimet.

Për të kuptuar në vija të përgjithshme, pa hyrë shumë në analizë, sepse ky komision i nderuar nuk është vendi për të bërë një analizë kaq të detajuar lidhur me euron, pasi kjo çështje ka nevojë për një analizë shumë të detajuar, për t'ua shpjeguar qytetarëve, publikut shqiptar, që pse jo euro por lekë, shtetet që kanë pasur ekonomi më të dobët në Bashkimin Europian, si Greqia etj, në momentin e prezantimit të euros, kur u bënë pjesë e eurozonës dhe pranuan monedhën europiane, patën shtrenjtësimin më të madh të jetesës, në krahasim me shtetet më të zhvilluara, si Gjermania, Franca e me radhë. Pra, në këto terma, sikur të ndodhte, po që nuk mund të ndodhë, sigurisht që do të ndikonte menjëherë negativisht në mirëqenien e qytetarëve shqiptarë. Pra, nuk kuptohet, duket sikur shmanget risku i këmbimit, por është shumë e komplikuar, pasi ka të bëjë me stabilitetin e çmimeve.

Kësisoj, aktualisht, për ne është e pamundur të kemi euron si monedhë. Ka shtete që janë anëtare të Bashkimit Europian, si Rumania, Çekia apo shtete të tjera, të cilat vazhdojnë me monedhën e tyre, sepse nuk kanë arritur të përmbushin parametrat ekonomikë, apo sepse ekonomia e tyre nuk është forcuar në ato nivele, që të jetë e gatshme për të implementuar euron. Sigurisht, ato janë shumë afër futjes së euros si monedhë kombëtare, pasi ekonomitë e tyre, si vende anëtare të Bashkimit Europian, janë rritur dhe kanë janë progresuar mjaftueshëm. Pra, brenda pak vitesh ata do të prezantojnë edhe euron, por akoma sot, këto ekonomi që janë shumë herë më të fuqishme se vendet e rajonit tonë, vazhdojnë me monedhën e tyre.

Erion Braçe – Zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit kryetar!

Natyrisht, e vlerësoj opinionin tuaj në lidhje me buxhetin e këtij viti që vjen. Gjatë fjalës tuaj, ju sugjeruat një sistem të thjeshtë tatimor, ndërkohë që ne kemi një sistem me nivele taksimi, për të mbrojtur kategori të ndryshme të biznesit.

Pyetja ime është kjo: sipas opinionit tuaj, cilat janë efektet ekonomike që na sjell ky sugjerim juaji, domethënë, sistemi i thjeshtë tatimor?

Gentian Sejko – Faleminderit, zoti Vorpsi!

E para, duhet të kemi sa më pak ndryshime në sistemin tatimor, pasi ndryshimet e shpeshta në sistemin tatimor nuk janë të pëlqyeshme nga investitorët vendës e të huaj, pasi krijojnë pasiguri dhe çorientojnë aktivitetin e biznesit. Sistemi tatimor është atributi i ekzekutivit, i qeverisë shqiptare, i Ministrisë së Financave. Sigurisht, ne si Bankë Qendrore shohim parametrat kryesorë makroekonomikë, konsolidimin fiskal, uljen e nivelit të borxhit, japim rekomandime të përgjithshme. Nuk hyjmë në vlerësimin e sistemit tatimor, sepse nuk është fusha jonë ligjore, as e ekspertizës, por as ligjërimit nuk e kemi. Sigurisht, parimisht ne japim këto rekomandime. Kjo është shumë subjektive dhe komplekse pastaj, është sa e thjeshtë po aq e komplikuar.

Ajo që ne vëmë re, është se sistemi ynë tatimor është një sistem mjaftueshmërisht atraktiv për tërheqjen e investimeve të huaja. Natyrisht, mund të thjeshtohet më shumë, mund të komplikohet edhe më shumë, kjo varet.

Nuk dua të komentoj më gjatë, sepse nuk është atribut i yni, nuk është as fusha jonë e ekspertizës për të vlerësuar dhe gjykuar në lidhje me nivelin e sistemit tatimor. Faleminderit!

Erion Braçe – Po, faleminderit!

Zoti Bushaj.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Sejko, për mendimet dhe sugjerimet që dhatë në lidhje me këtë projektbuxhet, këtë element shumë të rëndësishëm të aktivitetit të vendit tonë për vitin 2019. Pyetja ime kishte të bënte me treguesin e kredive të këqija, se si ka qenë ecuria nga 2013-a e këndeje, duke e vlerësuar këtë si një tregues sintetik dhe shumë domethënës për ecurinë dhe stabilitetin e treguesve ekonomikë. Pyetja e dytë: gjithmonë sipas mendimit tuaj, a është në gjendje ekonomia shqiptare, që me fondet brenda vendit, nga institucionet financiare, por qoftë edhe ato nga jashtë, t'i thithë dhe t'i përdorë këto fonde me efektivitet dhe eficiencë?

Pyetja e tretëm ka të bëjë me kushtet dhe kriteret e produkteve që ofrojnë bankat e nivelit të dytë...

Erion Braçe – Jo, zoti Bushaj, nuk jemi për këtë. Jemi mbledhur për tjetër gjë, një gjë komplet tjetër.

Xhevit Bushaj – Mirë, zoti kryetar, patjetër, por ka të bëjë...

Erion Braçe – Nuk ka të bëjë. Jo, zoti Bushaj, jo, nuk do të merremi me produktet e bankave. Jemi mbledhur për opinionin e Bankës së Shqipërisë në lidhje me buxhetin e shtetit për vitin 2019. Të lutem!

Xhevit Bushaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Erion Braçe – Të lutem!

Gentian Sejko – Faleminderit, zoti kryetar! Faleminderit, zoti Bushaj!

Lidhur me NPL-në, masat e marra janë gjë e njohur. Thjesht plani i masave i qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë, për uljen e nivelit të kredive me probleme, ka pasur sukses. Ne e kemi ulur nivelin e kredive me probleme si rezultat i këtij plani masash, i cili lidhet me shuam elementë, si me ristrukturimin e kredive, me fshirjen e kredive nga bilanci, me trajtimet ligjore, përmirësimet ligjore, për ekzekutimin e kolateralit, ligjin e falimentit, si dhe me shumë elementë të tjerë, të cilët ndikonin në uljen e kredive me probleme, në bashkëpunim edhe me bankat e nivelit të dytë, ne kemi arritur ta menaxhojmë. Ka qenë një sfidë e madhe, një punë shumë e madhe, por niveli i NPL-ve ka rënë dhe do të vazhdojë të bjerë. Në shumë absolute do të vazhdojë të bjerë, por kjo lidhet edhe me rritjen e tepricës së kredisë. Pra, nëse do të rritet më shumë kredia, do të bjerë edhe më shumë. Në rast se nuk do të rritet, mund të mbetet një përqindje e caktuar, por niveli i NPL-ve, i kredive me probleme do të bjerë. Shpresojmë të vazhdojmë ta ulim. E kemi ulur nivelin 12, 9 %, nga 25 %. Duhet thënë se ne kemi një trajtim shumë prudent në prezantimin përqindjes së kredive me probleme. Pra, ne bëjmë prezantimin më konservator të mundshëm, pasi të gjitha këto kredi janë të provigjionuara dhe të mbuluara me kolateral. Pra, bankat kanë fonde rezervë dhe i kanë mbuluar si humbje, disa i kanë fshirë fare dhe tashti presin vetëm rimarrje, por janë edhe të kolateralizuara. Shumë shtete të tjera, në nivelin e NPL-së, kur janë të kolateralizuara e zbresin. Pra, në rast se ne do të bënim këtë veprim, ndoshta niveli i NPL-ve mund të shkonte në shifrën 5 % - 6 %.

Ne kemi zgjedhur një mënyrë llogaritjeje sa më prudente, sa më konservatore, që të kishim edhe një adresim dhe referim sa më konservator. Po ecim në drejtimin e duhur, në lidhje me uljen e kredive me probleme. Lidhur me tërheqjen e fondeve dhe absorbimin nga ana e ekonomisë shqiptare, them se ekonomia shqiptare i ka kapacitetet për tërheqjen e fondeve. Kjo është një sfidë, që lidhet me shuam elementë të tjerë.

Ekonomia shqiptare si ekonomi tregu ka potenciale të mëdha. Si rregullatorë, qoftë qeveria shqiptare, qoftë agjencitë e tjera ligjzbatuese, duhet të jenë sa më pak burokratike, që të kemi një nivel sa më të ulët korrupsioni, të kemi një koordinim sa më të mirë në tërheqjen e investimeve të huaja, në mënyrë që të jemi në gjendje të përthithim. Procedurat e

prokurimit duhet të jenë sa më praktike, sa më të thjeshta, në mënyrë që fondet që ne kemi në dispozicion... Ne kemi fonde në dispozicion në institucione ndërkombëtare, si Banka Botërore, Banka Europiane për Ndërtim dhe Zhvillim, Banka Europiane e Investimeve. Ka shumë fonde, të cilat mund të tërhiqeshin me më pak burokraci dhe me më shumë praktikitet nga organet tona ligjzbatuese. Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Për ta mbyllur, zoti Guvernator, nesër ne kemi një seancë të posaçme të këtij komisioni, për të diskutuar lidhur me partneritetin publik privat, dhe natyrisht, atë pjesë të buxhetit të shtetit që angazhohet dhe vitin e ardhshëm për kryerjen e pagesave përkundrejt këtyre kontratave. Ju dëgjova me vëmendje që e vutë theksin në tri çështje: së pari, thatë, disiplinimi i kontraktimit të tyre. Së dyti, standardet më të mira të kontabilitetit të aplikohen për kontabilizimin e tyre. Së treti, përfshirje të tavanëve të larta në buxhet, për partneritetin publik privat.

A mund të më shpjegoni fare thjeshtë se çfarë synojmë me secilën prej tyre? Pra, çfarë keni parasysh kur flisni për disiplinim të kontraktimit të tyre?

Gentian Sejko – Kur flasim për disiplinim të kontraktimit të tyre, kryetar, kemi parasysh se, në radhë të parë duhet të ndjekim listën e prioritetëve strategjike të zhvillimit të ekonomisë shqiptare në kontraktimin e programeve të partneritetit publik privat.

Ka një listë të strategjive kryesore. Pra, mund të kemi strategji kryesore zhvillimin e infrastrukturës, që janë rrugët ose spitalet. Përgjithësisht, projektet e partneritetit publik privat duhet të ndjekin këtë lloj strategjie, dhe kontraktimi duhet të ecë në këtë linjë. Pra, propozimet e pakërkuara ose propozimet e tjera duhet të shihen me kujdes, që të mos dalin kundër prioritetëve strategjike të zhvillimit të vendit.

Lidhur me kontabilizimin, kjo ka të bëjë me atë që unë përmenda, me një trajtim dhe analizë sipas standardeve ndërkombëtare, me reflektimin dhe kontabilizimin e projekteve të partneritetit publik privat në buxhetin e shtetit, në mënyrë që, e para të ketë analizë sa më të saktë, e dyta të ketë një kontabilizim sipas standardeve ndërkombëtare, në mënyrë që të mos ndikojë, ose ta njohim në mënyrë realiste vlerën dhe efektin e PPP-ve në nivelin e borxhit. Pra, ta dimë sipas standardit ndërkombëtar, se sa këto pagesa për PPP-të do të ndikonin në nivelin e borxhit, në mënyrë që të respektojmë edhe pikën e tretë që ju thatë: nivelin e tavanëve. Pra, ka një kufi, ka një limit. Ky limit prej 5 % i të ardhurave është vënë për këtë arsye, për këtë qëllim, që të mos kemi ndonjë ndikim negativ në nivelin e borxheve, pasi kemi rënë dakord se do ta ulim nivelin e borxhit, kemi një objektiv për konsolidimin fiskal dhe uljen e nivelit të borxhit. Për vitin që vjen kemi thënë 65, 5, nga 69, 1 në 2018-ën.

Atëherë, që të mos kemi ndikim negativ nga kontratat e PPP-ve, ne do të duhet të respektojmë këtë tavan.

Një pikë tjetër që unë përmenda, ishte: sipas parashikimit të bërë, është që për çdo shpenzim shtesë, të paparashikuar, ne do të duhet të prekim nivelin e të ardhurave. Ajo që gjykojmë është se ne nuk duhet t'ia adresojmë të ardhurave, por të ulim nivelin e shpenzimeve. Për të pasur miradministrim, është më mirë të shohim nivelin e shpenzimeve. Pra, në qoftë se neve do të na rriten të ardhurat nga PPP-të, si pasojë e investimeve të paparashikuara, atëherë është mirë të jemi më konservatorë me shpenzimet. Këto ishin ato që po thosha.

Erion Braçe – Nejse, kam përshtypjen se kjo e fundit është e rregulluar me ligjin “Për buxhetin”, dhe natyrisht, ky komision s’e ka ndërmend të cenojë asnjë pikë të atij ligji, veçanërisht tavanin prej 5 përqindësh të të ardhurave në raport me shpenzimet e kontratave të partneritetit publik privat.

Mirë. Atëherë, zoti Guvernator, do të doja t’ju falënderoja për opinionin tuaj në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2019 dhe projektligjet financiare që e shoqërojnë atë.

Unë besoj se opinionin juaj do të na vlejë shumë në diskutimin nën për nen të një pjese të rëndësishme të projektligjeve financiare, por edhe të buxhetit të shtetit, për të reflektuar në maksimum të gjitha vlerësimet tuaja, por edhe paralajmërimet e bëra nga Banka e Shqipërisë në raport me një sërë elementësh kyç, të cilët lidhen me këto projektligje.

Faleminderit edhe një herë!

Gentian Sejko – Faleminderit, kryetar! Faleminderit kolegëve!

Erion Braçe – Ndërkohë, komisioni vazhdon me dy çështjet e tjera.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 12.30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ervin Bushati dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Mira Rakacolli, Zëvendësministre, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë

Albana Fico, Drejtor, Insituti i Shendetit Publik

Genc Burazeri, Nendrejtor Instituti i Shendetit Publik

Alban Ylli, Shef Departamenti, Insituti i Shendetit Publik

Erion Braçe – Kalojmë te dy projektligjet që kemi për shqyrtim, të cilët do të jenë në seancën plenare të ditës së enjte.

Së pari fillojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Për të prezantuar projektligjin, ndodhen në komision zonja zëvendësministre e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Mira Rakacolli.

Fillojmë me prezantimin nga ana juaj, zonja zëvendësministre. Më pas vijojmë me relatin në emër të komisionit.

Fjala për ju!

Mira Rakacolli – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji që po paraqesim i hap rrugë përfundimit të një studimi shëndetësor demografik, treguesi e të cilit i shërbejnë Ministrisë sonë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por edhe më gjerë, për përcaktimin e politikave tona të fushës. Është një studim, i cili jep të dhëna direkt nga burimi, për tregues të tillë si lindshmëria, vdekshmëria foshnjore dhe amtare, ajo femërore, lindjet para kohe, zhvillimi psikomotor i fëmijëve deri 5 vjeç, niveli i kulturës shëndetësore dhe asaj ekonomike, stili i jetesës etj.

I bërë me një metodologji bashkëkohore dhe i shtrirë derë më derë në 18 familje, shpërndarë këto në çdo qark të Shqipërisë, i bën konkluzionet të përgjithësueshme dhe, nga ana tjetër, jo vetëm që ndihmon ministrinë për të bërë politikën në përgjithësi për vendin, por në veçanti sipas problemeve dhe treguesve të çdo qarku.

Një studim i tillë, por i një përmase më të vogël, vetëm në tre qarqe, ka shërbyer si bazë e politikave të strategjisë kombëtare të shëndetit 2016-2020 dhe disa programeve kombëtare të suksesshme të shëndetësisë. Për rëndësinë që ka dhe për vlerësimin e ecurisë së politikave shëndetësore të rajonit është mbështetur financiarisht nga qeveria zvicerane me një vlerë prej rreth 800 mijë frangash zvicerane, është mbështetur nga UNICEF-i me një sasi prej 150 mijë dollarësh nga UNFPA-ja me 200 mijë dollarë dhe nga disa institucione të tjera në një vlerë më të vogël prej rreth 50 mijë dollarësh.

Si rezultat i zgjerimit të disa kampionëve në mënyrë të përgjithësimit të rezultateve që ndërkohë përpunoheshin, ndryshimit të kursit të monedhave, sepse kanë qenë të përfshira frangat, lekët dhe dollarët, që të përfundojë studimi kërkohen edhe rreth 300 mijë dollarë nga

të cilat 100 mijë do t'i paguajnë organizatat e UN-së, ndërsa 200 mijë mendohet të financohen nga ministria jonë si përfituesi kryesor i këtyre të dhënave. Për këtë nuk do të kërkohej buxhet shtesë, por do të jenë nga vetë buxheti i aprovuar tashmë i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ju lutem, miratimin tuaj.

Erion Braçe – Faleminderit!

Fjala për zonjën Dhima, si relatore e komisionit.

Antoneta Dhima – Faleminderit, kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë” është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet sipas procedurave të parashikuara në nenet 32 dhe 39 të Rregullores së Kuvendit.

Marrëveshja është miratuar nga Këshilli i Ministrave në korrik të vitit 2018 dhe synon dhënien nga pala shqiptare të një kontributi financiar shtesë prej 22,5 milionë lekësh për përfundimin e studimit demografik dhe shëndetësor të Shqipërisë 2017-2018.

Raundi i parë i studimit demografik në fushën shëndetësore është kryer në vitet 2008-2009 dhe ka shërbyer për hartimin e politikave dhe strategjive për shëndetin. Me kalimin e viteve lindi nevoja për kryerjen e një studimi tjetër më të plotë dhe me të dhëna të përditësuara në këtë fushë. Për këtë arsye u miratua marrëveshja për kryerjen e shërbimit demografik dhe shëndetësor 2017-2018 me bashkëfinancim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe disa agjencive ndërkombëtare, të cilat janë: Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, Projekti Shëndeti për të Gjithë i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe UN Woman.

Në kryerjen e këtij studimi marrin pjesë edhe Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Statistikave Zyrtare. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është drejtuese dhe përfituese kryesore e projektit. Ky studim shërben për të nxjerrë dhe ofruar të dhëna demografike dhe shëndetësore për disa grupmosha dhe kategori të popullsisë, si: fëmijët e moshës 0-5 vjeç, gratë shtatzëna, gratë e moshës riprodhuese dhe individët me moshë madhore. Këto të dhëna nuk ofrohen nga administrata apo nga studime të tjera. Të dhënat e këtij studimi do të ndihmojnë në modifikimin e programeve e politikave ekzistuese dhe hartimin e politikave dhe strategjive të reja për shëndetin e popullsisë, krahasimin e treguesve të periudhave të ndryshme, si dhe

pasurimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar me tregues të rëndësishëm demografikë e shëndetësorë.

Kostoja fillestare e plotë e studimit demografik e shëndetësor 2017-2018 ishte rreth 1.4 milionë dollarë amerikanë ose rreth 167.1 milionë lekë. Në muajin gusht 2017, Komiteti Drejtues i Studimit Demografik Shëndetësor analizoi punën studimore të kryer dhe konkludoi që vlera e parashikuar për t'u financuar ishte e pamjaftueshme. Për përfundimin e këtij studimi nevojitej një financim shtesë prej 300 mijë dollarësh, ose 33.5 milionë lekë. Palët ranë dakord që ky financim të përballohej nga pala shqiptare, në rastin konkret nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në shumën 22.5 milionë lekë dhe UNFPA-ja në shumën 11 milionë lekë. Për të siguruar këtë financim, u nënshkrua marrëveshja që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, në të cilën parashikohet që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin e donatorit, të japë një kontribut financiar prej 22.5 milionë lekësh për kryerjen e studimit demografik dhe shëndetësor 2017-2018. Ky kontribut do t'i jepet UNFPA-së, si administrues i procesit, pas ratifikimit të marrëveshjes. Kontributi do të jepet nga fondet e parashikuara në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nuk do të sjellë efekte në buxhetin e shtetit.

Mendime: mendoj se propozuesit e këtij projektligji duhet të na japin disa informacione për çështje si më poshtë: së pari, marrëveshja fillestare është lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencive Ndërkombëtare si bashkëfinancim i palëve. Ndërkohë, kjo ministri i ka të parashikuara në buxhetin e saj fondet për financimin shtesë.

Pse propozohet nga ana juaj që financimi shtesë të ratifikohet me ligj kur mund të ishte kryer e njëjta procedurë si në financimin fillestar, pra me marrëveshje të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale?

Së dyti, në relacionin e projektligjit përmendet si faktor ndikues një shtesë e kostos së projektit, ndryshimi i kursit të këmbimit. Megjithatë, në relacion nuk ka ndonjë analizë të plotë për financimin shtesë. Mendoj që propozuesit e projektligjit duhet të sjellin pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave një informacion të detajuar për punën e kryer deri më tani, shpenzimet sipas zërave kryesorë, efektin e faktorëve të ndryshëm në rritjen e kostos, punës që bëhet për t'u kryer dhe shpenzimet përkatëse sipas zërave kryesorë.

Së treti, në nenin 3, pika 6 të tekstit të marrëveshjes theksohet se “Në rast se ndonjë rrethanë e paparashikuar, që ka ndikuar në vlerën e kontributit, duke përfshirë rritjet e paparashikuara të shpenzimeve ose angazhimeve financiare, faktorë të inflacionit ose luhatje të kursit të këmbimit valutor, Fondet e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë mund të

kërkojnë financim të mëtejshëm nga donatori. Nëse financimi i mëtejshëm nuk është i disponueshëm ose i afërt nga donatori i aktivitetit, në të kundërt të programit mund të reduktohen, pezullohen ose ndërpriten.” Ndërkohë, në nenin 1 theksohet se: “Donatori është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

Sa më sipër, duket se ekziston risku i rritjes së mëtejshme të shpenzimeve për kryerjen e këtij studimi.

Në përfundim, propozoj Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të miratojmë këtë aktmarrëveshje.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Keni ndonjë shpjegim?

Person - Problemi i parë ka lidhje me memorandumin që është bërë. Në memorandumin që është firmosur në atë kohë nga ish-ministri Ilir Beqaj, angazhimi i Ministrisë së Shëndetësisë, në aspektin financiar, si donatore direkt, është zero. Instituti i Shëndetit Publik do të jetë në dispozicion të këtij projekti të madh me logjistikën e tij për të ndihmuar me implementimin e projektit. Gjatë implementimit të projektit, duke parë që u krijua një detyrim financiar që nuk mund të përballonte ekzekutimin e projektit, atëherë Ministria e Shëndetësisë mendoi të angazhohet duke pasur parasysh të gjitha argumentet e dhëna nga PNUD-i për sa i përket bashkëfinancimit të donatorëve të ndryshëm, por që kjo nuk mund të bëhej direkte, pasi në bazë të legjislacionit në fuqi, ky lloj memorandumit duhet të kalonte patjetër në parlament për t’u miratuar, sepse nuk kishte fuqi zbatuese nga ana e ministrit të Shëndetësisë për të bërë një pagesë direkte në favor të donatorëve për kompletimin e këtij projekti. Kjo është gjithë rruga e gjatë që ka përshkruar nga qeveria në parlament.

Së dyti, lidhur me ecurinë e ndryshimit të kursit të këmbimit, në momentin që është bërë projekti ky kurs shkonte gati 1 dollarë amerikan, gati 125 lekë. Gjithë projekti paguhet në lekë dhe zhvlerësimi i monedhës amerikane, rreth 107-108 lekë, solli një lloj impakti për uljen e buxhetit në përdorim.

Praktikat e llogaritjeve në atë kohë janë dorëzuar në Këshillin e Ministrave, ku është bërë projekti, edhe ne mund t’ia dorëzojmë Komisionit të Ekonomisë të gjitha llogaritë që janë bërë për të arritur në këto shifra.

Llogaria e projektit është 167 milionë dhe ky lloj buxheti është shterues, nuk ka buxhet shtesë përveç kësaj. 300 mijë dollarët kërkohen për të mbyllur *gape*-n nga 1 milion e 400 mijë dollarë që është aktualisht, në 167 milionë. Ndaj edhe lind pyetja se ku janë fondet.

Brenda fondeve të Ministrisë së Shëndetësisë, 22,5 milionë lekë e kemi shumë të lehtë për t'i gjetur diku dhe për t'i përdorur, por gjithmonë theksojmë se ky është një studim që i vlen Ministrisë së Shëndetësisë, ecurisë së dhënë strategjike që ne kemi për shëndetin dhe për një planifikim të drejtë sa u përket zhvillimeve demografike, etimologjike që janë në vendin tonë.

Erion Braçe – Ka pyetje dhe diskutime të tjera? Nuk ka!

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim projektligjin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Ervin Bushati dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Erjon Luci – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – specialiste në Drejtorinë e Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatmir Elezi – inxhinier në KESH

Anisa Pina – specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erion Braçe – Vijojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, të marrëveshjes së huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe Bankës

Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”.

Në komision ndodhen dy zëvendësministrat, zonja Dorina Cinari, zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe zoti Erion Luçi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Fillojmë me prezantimin nga ana juaj dhe më pas me relatorin, zotin Pëllumbi.

Erion Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky është një projekt që ka kaluar disa herë në komision dhe në parlament, është faza finale e projektit për t’u bërë tenderi për përmirësimin e portave të shkarkimit. Këto janë disa kursime nga një pjesë e projektit të BERZH-it, të cilat janë kërkuar nëpërmjet këtij projektligji për t’iu bashkuar pjesës tjetër të fondeve të dhëna nga Banka Botërore, për të cilën ju ratë dakord për të shtyrjen e afatit para disa kohësh. Pra, është thjesht një modifikim i marrëveshjes aktuale, nuk diskutohet të rritet apo të zvogëlohet huamarrja ose ligji që e mbështet këtë. Thjesht, bëhet një zgjerim i mundësisë së përdorimit të këtyre fondeve që janë 6,28 milionë për tenderin e madh të rehabilitimit të portave të shkarkimit.

Mund të diskutojmë për më shumë detaje, por besoj që është relativisht i diskutuar në disa momente të mëparshme. Kështu që nëse keni pyetje, kolegët e Sektorit të Energjisë do t’ju përgjigjen.

Erion Braçe – Po, urdhëroni, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi - Faleminderit për shpjegimet!

Po diskutojmë lidhur me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”.

Projektligji që po shqyrtojmë sot është propozim i Këshillit të Ministrave në përputhje me nenet 78, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 68, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 17 të ligjit nr.43/2016, datë 21.4.2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton atë në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32 dhe 33 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji i miratuar në parim me vendimin e Këshilli të Ministrave nr. 677, datë 14.11.2018, ka për qëllim miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen e huasë së dhënë nga BERZH-i për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, i cili ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2013. Sipas marrëveshjes bazë të huasë së

ratifikuar me ligjin nr.103/2013, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim angazhoi të akordonte huanë prej 12,700,000 eurosh, për të ndihmuar financimin e projektit “Për përmirësimin e sigurisë së digave në hidrocentralin e Komanit” dhe konkretisht programeve të investimeve për fuqizimin e masave për mbrojtjen nga shkëmbinjtë dhe rregullimin e shtratit të rrjedhës dhe zonën e gërryerjes së digës.

Në marrëveshje projekti pritej të përfundonte brenda datës 31 dhjetor 2015, ndërsa disbursimi i fondeve do të ishte i mundur të bëhej deri në datën 31 dhjetor 2016. Punimet civile do të bashkëfinancoheshin nga Banka Botërore, Bashkëpunimi Zvicerian (SECO) dhe KfW-ja, ndërsa shërbimet e konsulencës për mbikëqyrjen e projektit do të financoheshin nga Banka Botërore.

Këto punime tashmë janë kryer 100 % dhe nuk kanë konsumuar të gjithë kredinë e aprovuar më sipër. Për këtë arsye propozohet projektligji që po shqyrtojmë sot, i cili kërkon miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, që mundëson përdorimin e shumës së kursyer nga përfundimi i projektit që arrin në vlerën 6,128,224 euro si dhe zgjerimin e programeve të investimeve në mënyrë që të përfshihen edhe rehabilitimi i portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit. Konkretisht marrëveshja ndryshuese përmban amendimet e mëposhtme:

- Rishikimin e pjesës A të projektit për përforcimin jo vetëm të zonës së grykës së digës por edhe të zonës në depozitimin e majtë si dhe reduktimin shumës së alokuar për këtë pjesë nga 10 milion euro në rreth 5,620,000 euro.

- Reduktimin e shumës së alokuar të huasë për pjesën B që kishte të bënte me fuqizimin e masave për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve nga 2,573,000 euro që ishte parashikuar në 2013 në rreth 825,201 euro.

- Propozimin e një programi investimi të ri për rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit, i cili parashikohet të financohet në masën 6,128,224 euro.

- Zgjatjen e afatit të disponueshmërisë së fondeve nga data 31 dhjetor 2016 në 31 dhjetor 2021.

- Zëvendësimin e emërtimeve (duke parasysh që kjo marrëveshje është financuar në vitin 2013 dhe kemi ndryshime emërtime nga “Ministria e Financave” në “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, si dhe reflektimin e ndryshimit të adresës përkatëse

Në përfundim të fjalës sime, duke pasur parasysh që funksionimi i sigurt dhe i besueshëm i hidrocentralit të Komanit si një nga hidrocentralet më të mëdhenj në vend, nuk është vetëm çështje sigurie, por përbën gjithashtu edhe një burim potencial të menaxhimit të

të ardhurave për qeverinë në të ardhmen, i propozoj komisionit miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, me propozimin për ndryshim në nenin 2 të projektligjit, me qëllim hyrjen menjëherë në fuqi të tij.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Ka pyetje dhe diskutime? Nuk ka!

Kalojmë në votim. Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”. Kush është kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1. Kush është kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2 me propozimin e zotit Pëllumbi, do t’i kërkohet konfirmimi Presidentit, me qëllim që në seancë plenare të votohet hyrja në fuqi menjëherë. Kush është kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim projektligjin në votim në tërësi. Kush është kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit!

Nesër në orën 10.00 fillojmë seancën dëgjimore me ministrin e Financave për çështjen e koncesioneve dhe PPP-të dhe menjëherë pas seancës dëgjimore do të votojmë në parim projektligjin e buxhetit të shtetit dhe projektligjet financiare që kemi shqyrtuar ndërkohë.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA